Festivali Ndërkombëtar i Poezisë
“Ditët e Naimit”

Biblioteka
MERIDIANE POETIKE

Përgatiti
Shaip EMËRLLAHU

Këshilli botues
Giuseppe NAPOLITANO
Craig CZURY
Silke Liria BLUMBACH
Xhelal ZEJNELI
Ndue UKAJ
Niels HAV
Francoise ROY
Artan ARSLLANI
Shaip EMËRLLAHU

Përktheu
Silke Liria BLUMBACH

Ballina dhe ilustrimet
Majlinda KELMENDI

www.ditetenaimit.org

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë
"DITËT E NAIMIT"

Edicioni XXI

VALLËZIM REFUGJATI

Ditët e Naimit
Tetovë, 2017

KULTURA BOSHTI KRYESOR I NJË POPULLI

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë « Ditët e Naimit », gjatë këtyre dy dekadave ka arritur që t'i bashkojë një numër të madh krijuesish vendorë dhe ndërkombëtarë më renome botërore, të cilët i dhuronin publikut dhe lexuesit tonë vargjet e tyre që burojnë nga thellësia e shpirtit, e të skalitur në mendjën dhe vetëm me pendën e artistit.

Letërsia shqiptare eshte shumë e vonshme, po të krahasohët me letërsitë e popujvet te tjerë. Mirëpo, gjatë kësaj kohe të shkurtër ekzistojnë një numër i madh krijuesish qe janë përkthyer në gjuhë të huaja. Bartësi dhe përfaqësuesi i letërsisë sonë në botë është shkrimtari Ismail Kadare, i cili permes veprave tij, bëri që Shqipëria dhe kultura jonë të njihet në çdo kontinent. Letërsia jonë edhepse shumë e vonshme në atdhe, rrënjët e krijimtarisë i ka te autorët me origjinë shqiptare në shumë vende të botës, dhe prej tyre emra botëror që fituan çmimin Nobel për letërsi. Nuk duhët të merret tendencioze nëse themi dhe konfirmojmë permes dokumenteve historike se një pjesë e madhe e autorëve antikë të Greqisë jane me origjinë shqiptare dhe se «liliada» e Homerit e shkruar në verzionin origjinal i ka mbi pesëmijë fjalë ilire.

Të gjithë krijuesit vendorë dhe ndërkombëtarë të cilët ishin pjesëmarrës në edicionet e mëparëshme "Ditët e Naimit", në këtë hapësirë deklamuan fjalët më të bukura artistike të tyre të thurura në vargje, të cilat u grumbulluan dhe u sistemuan duke na e mundësuar që prej tyre të ngrejmë lartë permendoren e poezisë, që po vazhdon të ndërtohet me fjalët dhe gjuhët e popujve të mbarë botës, e cila do t'i qendrojë shekujve dhe do t'i shërbejë gjeneratave të ardhëshme, duke e përçuar mesazhin se, vetëm kultura është ajo e cila i bashkon popujt pa dallim race e gjinie, pa dallim religjioni e partie, pa dallim moshe e posti qeveritar. Kultura është boshti dhe ambasadori më i mirë i çdo shteti dhe populli.

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë «Ditët e Naimit» , ka filluar para dy dekadave në kushte shumë të vështira politike dhe ekonomike që asokohe e kishte kapluar hapësirën ballkanike, që askujt apo pakkujt do i shkonte ndërmend për themelimin e një festivali të poezisë siç e kishte vendosur poeti dhe profesori Shaip Emërllahu, që në thellësinë e shpirtit të tij buronte dashuria për fjalën e shkruar artistike. Për t'u ngritur një festival i tillë, siç është Festivali Ndërkombëtar «Ditët e Naimit», drejtori Shaip Emërllahu është dashur të sfidonte pen-

gesa të shumta të natyrave të ndryshme, që nuk kishin të bënin asgjë më poezinë dhe që kishin të bënin me poezinë. Më një përkushtim të pa krahasueshëm dhe më një dashuri ndaj artit dhe popullit, Shaip Emërllahu dhe ekipi i tij arritën që për më shumë se njëzetë vite të ngrehin tempullin që quhët Festivali Ndërkombëtar i poezisë « Ditët e Naimit » që aktualisht njihët si njëri ndër festivalët me të mëdha të poezisë në bote. Viktor Hygo (Victor Hugo) shkruante se «Poezia e një populli është elementi i progresit të atij populli». Shaip Emërllahu i brumosur më dy dashuritë; në dashurinë ndaj poezisë dhe në dashurinë ndaj popullit, do t'i tejkalonte të gjitha pengesat vetëm e vetëm që poezia e popullit të tij të kalonte hapësirat shqiptare, dhe letërsia që zhvillohej në botë të depërtonte edhe në këtë pjesë të Ballkanit që dikur ishte djepi i civilizimit botëror.

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë «Ditët e Naimit», është një udhëkryq i rëndësishëm i zhvillimeve letrare, jo vetëm për krijuesit vendorë, por për të gjithë poetët e mbarë botës, të cilët vit pas viti takohen në Tetovë duke na sjelle krijimet e tyre poetike më të mira, që bashkarisht t'i përjetojmë ato vargje, që bashkarisht t'i gëzohemi të arriturave të secilit prej nesh në këtë fushë të imagjinatës së krijuesëve te te gjitha kontinenteve.

Grumbullimi i poetëve në Tetovë gjatë Festivalit Nderkombetar te Poezise «Ditët e Naimit», është një pasurim shumëdimensional për të gjithë pjesëmarrësit ndërkombëtar dhe vendorë, sepse këtu gërshetohen kultura të ndryshme të vendëve më pak të zhvilluara, e më shumë të avancuara në letërsi, e të gjithë bashkë e përbëjnë një strumbullar të çmueshëm, i cili pastaj përçon mesazhe poetike në katër anët e globit. Poezia ndër artet më të bukura, i ka bashkuar në Tetovë në Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë «Ditët e Naimit», jo vetëm thjeshtë poetët, por krijuesit e shumë vendeve të botës të cilët shpirtërisht janë hyjnorë siç shkruante Apollineri (Apollinaire)« Poezi e brishtë! Më e bukura art ndër artet! Ti që na nxitë pushtetin kreativ, na afron afër Hyjnisë".

Në pamje të parë poetët nuk dallojnë prej njerëzve të thjeshtë, mirëpo në thellësinë e shpirtit të tyre ekziston një vullkan imagjinativ krijues, i cili vlon brenda për brenda vetes duke mos e lënë poetin të bëjë gjumë të qetë siç bëjnë të tjerët, e as të bisedojë siç flasin të tjerët sepse dashuria për poezinë dhe inspirimi që akumulohët duhët të shperthejë për t'u shkruar në letër e të marrë dhenë. Sjelljet, qëndrimet dhe dashurinë e poetit e kuptojnë vetëm krijuesit, ndërsa për të tjerët krijuesit janë të pakuptueshëm. Në këtë tempull të poezisë "Ditët e Naimit", për çdo vjet mblodhën shpirtërat më të sinqertë hyjnorë, ku secili në mënyrën e tij permes vargjeve

brilante kontribuojnë në këtë fushë të letërsisë që e stolisin me perlat më të çmueshme të shumë shteteve dhe popujve të mbarë botës.

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë "Ditët e Naimit", ka për qëllim që t'i tubojë për çdo vjet një numër të madh poetësh të vendeve të ndryshme të botës, në mënyrë që poetët vendorë të njihën më zhvillimet kulturore në botë si dhe anasjelltas, krijuesit e huaj të informohën më kulturën dhe letërsinë shqiptare. Kontaktët sistematike që krijohën gjatë këtij festivali, kanë rendësi të veçantë, sepse shkëmbehen pervoja dhe stile të ndryshme që e pasurojnë njëri-tjetrin, nga se poezia nuk është art që qendron në një vend, por ajo evoluon dhe pëson ndryshime të vazhdueshme, gjë që këtë art e bën të gjallë e të lëvizshëm drejt përsosshmërisë. Me plot të drejt mund të thuhët se, Festivali Ndërkombëtar i Poezisë "Ditët e Naimit", është një urë e shtrirë horizontalisht që i grumbullon vlerat dhe autorët, poezitë dhe poetët, një urë që i lidhë shtetët dhe popujt e që kontribuojne dukshëm jo vetëm në letërsi, por edhe në afrimin dhe bashkimin e krijesëve botëror.

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë "Ditët e Naimit", çdo vit ndan disa çmime letrare. Disa prej tyre bartin edhe emrin dhe figuren e poetit tone kombetar. Cmimi letrar "Naim Frashëri" më të cilin shpërblehet çdo vjet një poet, është ndër çmimet më prestigjioze të këtyre trevave ballkanike dhe jo vetem. Në këtë konkurencë tepër të madhe defilojnë emra shumë të respektuar dhe të rendësishëm në letërsinë botërore, ne mesin e te cileve edhe kandidate per cmimin Nobel.

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë "Ditët e Naimit", gjatë këtyre dy dekadave më batica e zbatica qendroi mbi themelet e veta, duke i përforcuar ato çdo vit me vargjet e bukura dhe duke i thyer të gjitha kufizimet e kufijve gjeografik, për ta ndërtuar një hapësirë të pakufishme në këtë planet më një gjuhë të përbashkët që quhët poezi, e njërzitë që e flasin këtë gjuhë quhen Poetë. Krijuesit kanë shpirtin e pastër, që nuk njohin sisteme nënshtruese, por zërin e tyre të artikuluar permes vargjeve e drejtojnë kundër çdo padrejtësie që ushtrohët mbi cilindo popull. Në imagjinatën e poetit nuk ekzistojnë padrejtësitë, shtypjet e torrturat, sepse për shpirtëra të tillë jeta është e barabartë për të gjithë njerëzit e këtij planeti. Nga mendja dhe fjalori i poetit rrjedh vetëm dashuri, paqe, tolerance dhe harmoni, e që të gjitha këto shprehen permes vargjeve të secilit nga ju.

Reshat SAHITAJ
Prishtine, 9 tetor 2017

Fitues i çmimit letrar “Naim Frashëri”

Xhorxh UALLAS (SHBA)

LIBRI

XHORXH UALLAS
(SHBA)

Poeti amerikan George Wallace është bursist-shkrimtar që banon përkohësisht në shtëpinë e lindjes së Walt Whitman-it, poeti-laureat i parë në Suffolk County, NY, dhe autori i 31 librave poezie në SHBA, Angli dhe Itali. Ish-vullnetari në Trupin e Paqes të SHBA-ve në Kore ka jetuar dhe punuar në Europë dhe Azi si dhe në vende të shumta në Shtetet e Bashkuara. Ka lindur në Nju Jork, ka jetuar dhe punuar për 5 vite në Mbretërinë e Bashkuar, ku ende udhëton rregullisht. George, ish-studenti i Marvin Bell-it dhe WD Snodgrass-it, ka kryer studimet për shkrim krijimtar në Pacific University në Oregon dhe jep mësime shkrimi në zonën e Nju Jorkut në Pace University dhe Westchester Community College. Vepra e tij është mbledhur në arkivat në Hofstra University, dhe poezia e tij është dokumentuar në Qendrën e Poezisë dhe Letërsisë në Librarinë e Kongresit në Washington DC.

Mes paraqitjeve të tij të fundit janë prezantime dhe bashkëpunime në: Festival Ledbury, Ways With Words (Rrugë me fjalë), Qendra Dylan Thomas, Qendra Robert Burns dhe Women's International Arts Festival (Festivali ndërkombëtar i artit i grave, Mbretëria e Bashkuar), About-Art dhe Skiathos Writing Retreat (Greqi); Centro Trevi dhe Odradek (IT); Festival d'Avignon (Fr); dhe në SHBA: Festivali Woody Guthrie, Festivali Kerouac, Howlfest, Festivali John Steinbeck, Qendra për Studime Helenike dhe Festivali Ndërkombëtar Beat.

Librat e fundit të vegjël poezie përfshijnë "Smashing Rock" (Shkëmb dërrmues) dhe "Straight as Razors" (Të drejtë si brisqe) (Blue Light Press '17), "A Simple Blues with a Few Intangibles" (Një blues i thjeshtë me disa të paprekshme) (Foothills Press '16) dhe "Poppin Johnny"

(Three Rooms Press '09). Ka dy përmbledhje dygjuhëshe të botuara në Itali nga La Finestra Editrice dhe një përmbledhje anglisht-greqisht të botuar në SHBA nga Three Rooms Press. Mes përmbledhjeve të tij në Angli janë "Burn My Heart in Wet Sand" (Digj zemrën time në rërë të lagur) (Transference, '04) dhe "When I Was Dead" (Kur isha i vdekur) (Flarestack '06).

Më 2012, Nirala Press në Indi botoi "Incident on the Orient Express" (Incident në Orient-Ekspress), një kronikë të përjetimeve të tij nëpërmjet poezisë dhe imazheve në udhëtimin nga Europa nëpër Lindjen e Mesme dhe Nepal deri më në fund në Indi me tren në vitet 1970.

Më 2017, regjisori izraelit i filmave dokumentarë Omri Lior filmoi George-n duke lexuar nga vepra e tij në shtëpinë e lindjes së Walt Whitman-it për serinë "Poems With A View: Poems from Around The World" (Poezi me perspektivë: Poezi nga gjithë bota).

PO TË MUND TË HIQJE TË VDEKURIT NGA TË VDEKURIT

Po të mund të hiqje të vdekurit nga të vdekurit, bombë për bombë, sy për sy, po të mund të shkulje demin e çmendur që ulërin, nga gjaku dhe pluhuri, nga arena, vdekja e shkrehur, jeta e kthyer, fushat e fytyrave, përqafimet e tyre, si trëndelinë, si mjaltë, dhëmb për dhëmb si bleta në bar, domethënë kur gjeneralët nuk shikonin, kur diktatorët nuk shikonin, kur brohoritjet idiote dhe talljet e turmës, kur gara rrethore çeliku dhe paraje dhe gjaku dhe mashkullorësie, kur kulti i shpatës, askush nuk shikon,

O sa e marrë qenka ta mendosh, o sa budalla ta përfytyrosh, të gjithë të vdekurit që flenë gjumë të ngrihen nga vdekja, gjenden në urë, shikojnë poshtë nga parapeti, e gjithë e qeshura pa lidhje, të pafajshmit të përkryer të ngritur prapë nga tufa, e gjithë kënga e patrazuar, asnjë zhgënjim më, asnjë harresë më, a po kupton ç'përpiqem të them, a mund ta shohësh për veten, bijtë dhe bijat e therura, gjysmatarë dhe ushtarë, studentë, infermiere, punëtorë fabrike dhe minatorë, të gjitha jetët e ëmbla të kthyera te të gjallët,

Dhe të gjithë prej nesh i përqafojnë kur ngrihen, do të desha që ti i përqafon, do të desha që i përshëndet dhe i kërkon dhe i mirëpret, të vdekurit nga të vdekurit, sy për sy, të lëshuar nga paraliza e tyre, të liruar nga pa-

dobia dhe dërgimi i gjumit të tyre të vdekur gërryes, të ngritur nga junta e dollarit dhe kombit dhe pushtetit dhe projektimit, duke i treguar klasës sunduese të vërtetën, duke u folur të folurit të vërtetën, atyre që i mbjellin të pakujdesshëm në dhe,

Jo, jo përsëri, jo më atë rrënjë dhe shkëmbin e ikjes! të vdekurit nga të vdekurit, që rimarrin plugjet e tyre dhe kapelat e tyre fermerësh, që tundin frerët që etërit dhe gjyshërit u kanë vënë në duart dhe kthehen në punën e tyre, me duar plot fara dhe ëndrra dhe kallot dhe djersë, a mund t'i dëgjosh si këndojnë këngën e të gjallëve, a mund të shohësh diellin e mëngjesit në fytyrat e tyre të bukura, buzëqeshjet e tyre depërtuese, a mund të ndiesh gjithë këtë, dashurinë e tyre të vogël, trimërinë e tyre, burra dhe gra, të ringjallur, zërat e nënave të tyre tingëllojnë butësisht në veshët e tyre,

Dhe unë jam aq budalla që e sugjeroj, jam aq budalla që e përfytyroj, të gjitha fytyrat e tyre në mjegullën e qytetërimeve dhe shiut idiot, të vdekurit e ndarë nga të vdekurit, plumb për plumb, sy për sy, që ecin përsëri, dorë për dorë, si dielli shëtitës.

OMAGGIO A L. ARMSTRONG

Është pjesa e dytë e shekullit XX bie borë dhe një burrë në Romë që je ti di të luajë në një trombë këtë këngë që ka kompozuar & është një ditë e mirë, a e di, një ditë shumë e mirë në mbretërinë e xhazit, një mrekulli ka ndodhur sot - ky burrë u lirua nga burgu Joliet & u largua nga Chicago & ka ndërruar emrin & ka ikur nga vendi & ka ardhur në Romë - në burg ka lutur për këtë

për të është mrekulli aq e madhe sa bora

& tani gjendet para bazilikës Santa Maria Maggiore & luan këngën e tij në borë që bie & kënga është tingulli i kumbarit të tij në Sabine Parish, Louisianë, në mëngjesin kur e kapën kur fshihesha në pishat & kënga është një pjesë dëshirë & dy pjesë lehja e zagarëve të Texas-it & kënga është dy pjesë të vdesësh & një pjesë një barkë peshkimi karkalecash deti në Louisianë

& qarkullimi & këmbësorët & bora në ajër

& xhazi është xhazi është xhazi është xhazi - & një femër e re mbi një biçikletë që shkonte mbrapa, një femër që mban një pardesy të zi, dorashka të zeza & një mbresë

të ngushtë të kuqe të përshtatshme & nën pallton e saj një bluzë të bardhë me kopsa perle - një femër që ka studiuar filozofi në universitet & për më tepër njeh një burrë që njeh një burrë që njëherë takoi Gregorio Corso-n por atëherë nuk dinte që ishte ai - një femër që vetëm pedalonte e lumtur & i qeshte borës

& e dëgjoi këtë këngë mbi zhurmën e qarkullimit

Një femër e re që ndali dhe zbriti nga biçikleta & shkoi për ta dëgjuar burrin me trombën që gjendej në borë para bazilikës Santa Maria Maggiore - & në mes të turmës mbi zhurmën e nxituar të qarkullimit dhe njerëzve & qytetit & gjithë borës ajo thotë diçka me zë të lartë -

Satchmo, thotë - Omaggio a Satchmo - Dhe fillon të vallëzojë

DUKE ECUR NËPËR TENTH STREET

Po ecim nëpër Tenth Street në drejtim të Neptune Diner-it një restorant polonez që i pëlqen Simonit por duhet të shkosh atje para orës 11 në mëngjes nëse dëshiron gjellën speciale të mëngjesit dhe kjo është e rëndësishme sepse Simonit i pëlqen të arrijë kur ende ofrojnë paradreken që do të thotë lëng portokalli pa kufi dhe filxhanë kafeje të nxehtë pa fund

Kur takohemi me Max Camber-in por s'ka kohë për të ndalur dhe biseduar dhe përveç kësaj Simonit nuk i pëlqen Max Camber-i këto ditë dhe nuk dëshiron të bisedojë me Max Camber-in ngaqë, edhe pse Max-i studioi film në Universitetin e Los Anxhelos-it, nuk di si t'i afrojë subjektet e tij me atë që Simoni quan objektivitet mirëkuptues

Dhe kështu shtrëngojmë dorën e Max-it dhe vazhdojmë të ecim dhe më në fund mbërrijmë në një bulevard ku perimeshitësi korean ngroh duart mbi një zjarr gështenjash dhe një shi i imtë po bie dhe Simoni më tregon për vizitën e tij të fundit në Provincetown ku po redakton veprën e zgjedhur të Robert Creeley-t dhe sa mirë qenka të punosh me djalin e Creeley-t sepse përkushtimi i këtij burri ndaj të atit është i admirueshëm dhe plotësisht i sinqertë

Dhe është pranvera në qytet dhe turistët po kthehen jo si herën e fundit kur erdha në qytet për ta vizituar Simo-

nin por kjo ishte një skenë e ndryshme ishim në rrugë për të pirë verë të kuqe dhe për të dëgjuar xhaz në Mo Pitkin's dhe ne të dy dukeshim finokë dhe fotogjenikë dhe të shkujdesur në bulevard kur disa demonstrues filluan t'i prishnin gjërat -- çmenduri! tha Simoni

Dhe ishte e çmendur ishte e çmendur dhe shumëngjyrëshe dhe gazmore ishte një paradë lulesh të mërzitura ishte parada Rosebowl dhe Festa e të Korrave dhe Dita e Shën Patrikut dhe Krishtlindjet të gjitha të luajtura në një

Dhe u ndalëm për t'i shikuar dhe për të bërtitur gjëra dhe për të buzëqeshur me banderolat e tyre të mëdha të mërzitura dhe grupin e policëve shoqërues por, si them unë, ka mjaft kohë dhe ishim engjëj të natës së Nju Jorkut
kurse ky është një mëngjes në ndonjë të enjte në pranverë dhe kur mbërrijmë në restorant "ka kaluar dhjetë e gjysmë" thotë kamerierja me theksin e saj të sjellshëm por të trishtë polonez mbi zhurmën e gjallë të banakut të kamerieres ndihmëskamerierëve pjatalarëseve lugëve pjatave dhe klientëve

Përplasja dhe kërcitja gazmore e botës
dhe ne shikojmë orën në mur
dhe e shikojmë njëri-tjetrin në veshjet tona të leckosura
dhe e shikojmë atë dhe gjithë botën perëndimore
që punon për të jetuar veç ne s'punojmë
dhe nuk na ha meraku më jemi të lumtur tani
kemi gjetur njëri-tjetrin
as nuk çajmë kokën për të paguar çmimin e plotë
për vezët tona mbi theka buke të thjeshtë thekre

USHQIMI YNË NË DUART TUAJA

Si mundet që një burrë shkon nëpër një super-market diku në Amerikë pa ndier shenjën e duarve të tua mbi gjithçka që prek - duart e shtrënguara në agun e vogëlimës buburrecit krimbave të rrumbullakët erës së bajgës - kova plastiku shami koke & vegla me dorezë të shkurtër - duar me ëndrra
fushash barbunjash shtretërish kashte & teli me gjemba - mëndafsh misri & dhallë - muzikë ujore që kërcen si peshq nga nata e kaltër mestice si e qeshura e familjes sate & për në ditë

Ti shtegton nëpër South Carolina si zhvendosja e mjegullës ti korr domate në Florida shtegton nëpër Delaware Maryland Connecticut & Maine korr patate molla soja bizele panxharë - panxharë spinaq & panxharë - kujdesesh për gjela, mëshqerra, pula & dosa - korr oriz të egër mbledh avokado & rrush mbjell xhufka të bardha resh në flokët e fëmijëve të tu si fara në parajsë

O sallatë jeshile! O luginë trime Salinas! - O arka të Kalifornisë!

Kumbulla kajsi qershi nga Oregoni në qese plastiku - në fushë të ulët & në majat e maleve të larta kastravecë barbunja lakër Brukseli arra pjeshka & bajame - stridha në guaskat e tyre - transmetim shpërndarëse plehu spërkatëse uji & thasë prej cohe të ashpër - si mundet që ndonjë burrë grua apo fëmijë në Colorado Alabama Arkansas Missouri Louisiana ose Illinois - ndonjë burrë grua apo fëmijë në Cochise County Arizona ose në Nju Jork shkon ndonjëherë nëpër një supermarket amerikan pa ndier fuqinë e syve të tu të qëndrueshëm - duke baraspeshuar secilën korrë & fushë të mbjellë në Amerikë me orët e mbetura të ditës - kurrizi yt qafa jote këmbët e tua supet e tua & veçanërisht duart e tua - familje të tëra duarsh - të lodhura të prera të mavijosura të ngrëna nga çimkat të ashpra nga puna - të padëshmuara të keqpaguara të mashtruara & po po gati për t'u nxjerrë përjashta

Sepse ti kthehesh, apo jo, ti gjithmonë kthehesh - digjesh nëpër mjegullën si dielli i kufirit, që shtegton nëpër secilin supermarket në Amerikë.

GJITHÇKA DO TË BËHET MIRË

Gjithçka do të bëhet
mirë. Bulkthat do të këndojnë
për ty. Gjethe panje
do të kthehen në ngjyrat e tyre
prej gjethe panje. Mjegulla veriore
do të zbriten nga Kanadaja
për t'i ftohur gjërat. Erërat
e tmerrshme do të fashiten,
do jetë tetori dhe
uraganët do të kenë ikur.
Në rregull, nuk do të jem këtu

por gjithçka do të
bëhet mirë. Qielli
do të hapë krahët përsëri
dhe do të të përqafojë
ashtu si vera të ka mbajtur
në krahët e saj të fortë. Ashtu si
dimri priret ta shtrëngojë botën
në borë por pastaj e lëshon botën.
Ashti si drita e diellit të mbante si badër
e verdhë në bar të gjelbër në pranverë. Para se
më takove, domethënë. Para se mbajta dorën tënde
në dorën time. Ashtu si kujtimi i
dorës sime në tënden do të të mbajë,
pasi të kem ikur. Të gjitha vitet
e gjata do të vazhdosh të jetosh
në këtë botë, pa mua.

Përktheu: Silke Liria Blumbach

NE E DOGJËM RRUGËN PËR NË NOWHERESVILLE[1]

Ajo kishte nevojë të pushonte, kaq, dhe tha,
diku vetëm që jetë larg të ftohtit,
kishte nevojë të fshinte diçka nga memoria e saj,
diçka të keqe që i kishte ndodhur
në Guatemala apo ndoshta diku jashtë në rrugë,
nuk kishte mjaft qiri për dritë
por ishte pragu I Vitit të Ri
dhe Viti I ri në Nju Jork supozohet të jetë i veçantë,

një kohë e fillimit të ri dhe fundeve të lumtura,
një moment kur koha ndalon
duke u merakosur për veten e vet
dhe prapë e quan veten me fat
që është gjallë dhe mirë.
Mbase mund ta ndihmoja atë për këtë,
do t'i blija një pije, ajo ishte afërsisht
shtatëmbëdhjetë vjeçe por s'mund ta provonte
ekzaktë, motra e saj jetonte në Bruklin
dhe i kërkoi asaj të gjente një vend për telefon.

Kishte një kabinë në një hyrje pallati
por motra e saj nuk kishte telefonuar akoma,
prandaj ajo po sillej vërdallë

[1] Përkthehet edhe si noëhere, askund, por edhe përdoret si zhargon.

Ju e shihni, asaj i mori dy ditë e gjysmë
për të ardhur këtu me Greyhound[2]
njerëzit në autobus
ishin budallenj dhe të çmendur
burri në sedilen ngjitur
do ta bezdiste atë,
ai vend ishte i ngrohtë dhe i rehatshëm,
Ata ikën të gjithë, faleminderit Zotit,
njerëzit ikin në drejtimet e tyre

vetëm të jenë të sjellshëm, po thoshte ajo,
në shtëpi prapë plasi sherri
dhe u rrënua gjithçka, njerëzit ishin të varfër,
ata u inatosën dhe vendosën të bënin diçka
kështu që ushtarët erdhën të armatosur
me pushkët e tyre yanqui, disa njerëz u vranë,
disa fshatra u dogjën, vëllai i saj katërmbëdhjetë vjeç
u vra me një plumb në ballë.

Ajo i donte sytë e tij, ata ishin të zbrazët
dhe ftues, a mund t'ju tregoj ju vetëm
si vallëzonim në fshatin tim, më tha ajo-
I thashë, sigurisht, pse jo
Unë s'jam kërcimtar i mirë por ishte
një vallëzim që i përshtatej trupit tim,
një vallëzim refugjati, ajo më përkundte
në krahët e saj, si një djep, si një varr,
sikur të ishim dy marinarë të një anijeje të mbytur
duke kërcyer në gropën e pafund
të një deti të boshatisur.

Dhe pesha e botës ngrihej e ngrihej,
telefoni në kabinë binte pa pushim,
koha ndaloi- ne e dogjëm rrugën për në Nowheresville
pastaj u ulëm prapë,
Ishte Dita e Vitit të ri.

[2] Linjë autobuzi në SHBA ku udhëtojnë zakonisht shtresat e ulëta.

SI NJË PJESHKE QË ÇEL NË SHIUN E DIMRIT

Unë kurrë nuk jam bezdisur nga zhurma që bën një qytet kur bëhet shumë i madh për ta përmbajtur veten, kur dritat kthehen jeshile dhe rrugët gjallërohen- kur muzika që dëgjohet brenda tij e kalon masën si një verë në shishe që do të dalë jashtë.

Apo zhurmat e vogla që bën një qytet, duke i kënduar vetes në agshol, kur askush nuk e dëgjon. Unë kurrë nuk jam bezdisur sepse kënga e faljes që një qytet ia këndon vetes, është më e bukur sesa rrahjet e violinës, jehona e flautit apo e martelit në rrugë.

Zhurmat e vogla të qytetit askush s'mund t'i dëgjojë, ndërmjet të gjitha zhurmave, kur i dëgjoj, ndjej kënge-ën e zërit tënd në të gjithë botën siç thoshte Pol Elyar, si zogjtë që këndojnë në një tendë në agim- jo, unë asnjëherë nuk jam bezdisur prej tyre.

Është Viti i ri, unë mund të shpërthej prej këtyre mureve që më kufizojnë, nga kjo muzikë xhazi që më mban brenda- është viti i ri, nuk kam mbaruar akoma, mund të këndoj një këngë, për çdokënd që është ende esëll për të dëgjuar.

Si një pjeshkë që çel në shiun e dimrit,
unë mund të çel prapë, me këngën tënde.

SYTË E TU QË SHKËLQEJNË SI PALESTINË

Gjembaçi shkon tek rrënja dhe kështu njeriu.
Jo, unë nuk jam religjioz dhe as nuk jam duke vdekur,
jo tani, unë jam natë,
nata është e qëndrueshme, nata është një hartë
pa yje, sa mijëra vjet kanë ardhur dhe shkuar,
unë jam secili prej tyre apo vetëm disa.
Nuk ka udhëzues që të ndjekësh, ok në rregull,
mençuria e shekujve është një nocion i dalë mode,
vijat në pëllëmbën e duarve tona
janë një shenjë që mjafton.

Ky sinjal i dobët, kjo inteligjencë e tjetërsuar
që sundon jetët tona, Dante nuk do ta donte këtë.
Çfarë na duhet është një pikë e fiksuar

natën, diçka e qëndrueshme që mund ta ndjekim,
diçka e besueshme si të dashuruarit e përkryer
që marrin frymë së bashku, ndjejnë të njëjtën gjë,
apo kjo re e vogël që ta kryqëzon fytyrën
natën, si fantazma e një prifti jezuit
që rrëshqet në oborr, si dyshimi
apo era, si Lorka apo një kokërr rëre
nga disa vende të shkreta apostolike e futur
në një kavanoz, si ti duke ndezur një cigare
apo unë duke ndezur një për ty.
Si vetë koha, që i bën dritë vetes, sepse koha
është e pavdekshme dhe e shumëfishon veten,
era ta vagëllon pamjen
si sulfuri i Trojës dhe nata është lëkura e
St Sebastian e shpuar nga njëmijë shigjeta-
plot me shigjeta si urchin deti[3]
Po, ti je e hutuar dhe dashuria jote është e rastësishme,
ne kemi qenë të gjithë të rinj dhe kemi dashuruar
megjithëse nuk e kemi ndjerë dhimbjen njësoj.

Ndaje gojën tënde me mua si hëna e kulluar-
zgjate gojën drejt parajsës, thuaj çfarë të duash,
fol si nga gremina, ja pse ajo është atje-
me zërin tënd saten, me buzët e tua
që janë skllevër të lirë, dhe ngjyra e arit të pastruar,
me sytë e tu që janë andaluzianë, zëri yt i hollë
që këndon si një pemëtore portokallesh në shi
dhe në një natë si kjo, unë mund të të përfytyroj
në një kohë të shkuar, si një kalush në një vathë,
gjaku yt që ndizet, thundrat që shtypin çdo gjë në rrugë,
kaktus, gurë, dhé toke.

Pikërisht ky është akti i rimishërimit, trupi yt si një port lidian,
timbri i zërit tënd, i vdekshëm si mijëra lundra greke

Vetë sytë e tu që shkëlqejnë si Palestinë.

[3] Një krijesë e vogël e detit me guackë rrethore që e ka lëkurën me thumba.

NE E DOGJËM RRUGËN PËR NË NOWHERESVILLE[4]

Ajo kishte nevojë të pushonte, kaq, dhe tha,
diku vetëm që jetë larg të ftohtit,
kishte nevojë të fshinte diçka nga memoria e saj,
diçka të keqe që i kishte ndodhur
në Guatemala apo ndoshta diku jashtë në rrugë,
nuk kishte mjaft qiri për dritë
por ishte pragu I Vitit të Ri
dhe Viti I ri në Nju Jork supozohet të jetë i veçantë,

një kohë e fillimit të ri dhe fundeve të lumtura,
një moment kur koha ndalon
duke u merakosur për veten e vet
dhe prapë e quan veten me fat
që është gjallë dhe mirë.
Mbase mund ta ndihmoja atë për këtë,
do t'i blija një pije, ajo ishte afërsisht
shtatëmbëdhjetë vjeçe por s'mund ta provonte
ekzaktët, motra e saj jetonte në Bruklin
dhe i kërkoi asaj të gjente një vend për telefon.

Kishte një kabinë në një hyrje pallati
por motra e saj nuk kishte telefonuar akoma,
prandaj ajo po sillej vërdallë
Ju e shihni, asaj i mori dy ditë e gjysmë
për të ardhur këtu me Greyhound[5]
njerëzit në autobus
ishin budallenj dhe të çmendur
burri në sediljen ngjitur
do ta bezdiste atë,
ai vend ishte i ngrohtë dhe i rehatshëm,
Ata ikën të gjithë, faleminderit Zotit,
njerëzit ikin në drejtimet e tyre

vetëm të jenë të sjellshëm, po thoshte ajo,
në shtëpi prapë plasi sherri
dhe u rrënua gjithçka, njerëzit ishin të varfër,
ata u inatosën dhe vendosën të bënin diçka
kështu që ushtarët erdhën të armatosur
me pushkët e tyre yanqui, disa njerëz u vranë,
disa fshatra u dogjën, vëllai i saj katërmbëdhjetë vjeç
u vra me një plumb në ballë.

---

[4] Përkthehet edhe si nowhere, askund, por edhe përdoret si zhargon.
[5] Linjë autobuzi në SHBA ku udhëtojnë zakonisht shtresat e ulëta.

Ajo i donte sytë e tij, ata ishin të zbrazët
dhe ftues, a mund t'ju tregoj ju vetëm
si vallëzonim në fshatin tim, më tha ajo-
I thashë, sigurisht, pse jo
Unë s'jam kërcimtar i mirë por ishte
një vallëzim që i përshtatej trupit tim,
një vallëzim refugjati, ajo më përkundte
në krahët e saj, si një djep, si një varr,
sikur të ishim dy marinarë të një anijeje të mbytur
duke kërcyer në gropën e pafund
të një deti të boshatisur.

Dhe pesha e botës ngrihej e ngrihej,
telefoni në kabinë binte pa pushim,
koha ndaloi- ne e dogjëm rrugën për në Nowheresville
pastaj u ulëm prapë,
Ishte Dita e Vitit të ri

DISA KATEGORI TË RASTËSISHME TË MREKULLIVE

Është krejt e qartë për mua, alkimia dhe të treguarit, triunf del amore[6], të treguarit e sekreteve, gonxhja e tmerrshme e zemrës tënde, vullkanike, rrethore si një sharrë argjendari, harmoni e gjallë, dryni melodramatik i rrethanave tuaja, madje kur merr frymë, të gjitha të rrëfyeshme, po, unë mund të dëgjoja për orë të tëra, të gjithë natën në errësirë, formën e frymëmarrjes tënde të gjallë, një flakë qiriri, bukurinë e tmerrshme.

Çdo gjë mund të prekë, çfarë thonë buzët e tua, dhëmbët, gjuha, si e formësojnë ata errësirën, sesi në errësirën më të thellë të natës ndodh davaritja e territ,

Një vidër rrëshqet në mjegullën e lumit, tymi blu nga zjarri i kabinës, çfarë supozohet të jetë vetmi është nxirje e diellit, një diell që ka qëndruar mbi re me vite, ky mall është brenda jush, i pandërprerë, për të ushqyer dhe puthur gojën tënde të fshehtë, të jetë një vidër, një ylber, troftë, loon[7], për tu ushqyer dhe puthur prej jush, të tregojnë gjëra të patregueshme, gjëra të shenjta, të gjitha budallëqe, të gjitha të rrëfyeshme.

[6] Triumfi i dashurisë, poezi e Judith Nantell
[7] Një zog i madh që ushqehet me peshk në Amerikën e Veriut dhe klith si duke qeshur.

Këto krahë, këto duar, këto rrahje krahësh, në majë të gjuhës time, në bazë të kurrizit tim, ku fillon burrëria ime, unë mund të shijoj këtë masë argjendi, këtë zgjim të borës së shkrirë, këto janë vathët e tu, perlat e tua, unë i vë ato në gojën time dhe i thith si gurë, mbush flegrat e hundëve me to, me frymëmarrjen e tyre të pamëshirshme.

Për ty një shkëmb drejt djepit, një lumë drejt shkëmbit, i mëshirshëm, buzët e tua, gjuha, dhëmbët, flokët, afrimet e mesnatës, brumosja e këtyre konturave, në imagjinatën time unë jam dhjetë këmbë i gjatë, i zhveshur dhe jvaji.

Kjo bie jashtë kategorisë së mrekullive dhe bën dritën e vërtetë të ditës, kjo zonë, kjo gjurmë kafshe, strall, strall, strall, transformim i qeramikës dhe shkëmbit, disa kategori të rastësishme të mrekullive, ky triumf mbi rendin natyral i jvaji, brenda jush, pranë jush, që mbush mushkëritë e mia.
Kjo do të më bëjë mua të qaj, do të bëjë klithmën e dhelprave të këndshme, fushën dhe pyjet e paqeta, të shenjta, të shenjta!

Një tufë fazanësh lëvizin përgjatë cepit të një are misri, unë mbështes veshin tim tek ty, gumëzhimën e zërit tënd në gurmaz, si bima e gjembaçit kur merr frymë, e gjitha e dëgjueshme, e dëgjueshme, kjo përjetësi, ky përqafim i parë, e gjitha e mrekullishme, e re dhe përjetësisht e dëgjueshme.

Për mua, ky fluturim zogjsh, kjo ujëvarë e ujit alpin, krahët dhe britmat dhe akulli i shkrirë, shkëmbi i lumit, i dëgjoj ato të gjithë sonte dhe ty të shtrirë këtu pranë meje.
frymëmarrjen tënde të veçantë,
gulçimet e tua të buta të çudisë së mrekullueshme.

KJO SHPËRHAPJE E DRITËS NË TË CILËN UNË FSHIHEM NË IMAZHIN TËND

Kjo shpërhapje e dritës në të cilën unë fshihem në imazhin tënd, parandjenja e parë e takimit me ty, momenti kur të mora dorën dhe po shëtisnim në një park qyteti, vjeshta ende nuk ishte e ftohtë, thjesht të marrësh frymë ishte e mrekullueshme, si një bukë e thekur dhe e freskët dhe trotuari vezullonte, një dritë e zbehtë ngacmonte kuqëlimin e flokëve të tu, një dritë e jashtëzakonshme, natyrale përkundej lehtas.

Ju ishit gjithnjë në formën më të mirë siç thoshe, dhe unë përpiqesha ta mbaja vështrimin tek ti ndërsa memorizoja lëvizjen e syve të tu, të formës së gojës, që ishte një pasazh nga Gabriel Faure, qeshjen tënde, që ishte fantomë e verës së ndriçuar, pamjes tënde të menduar dhe bisedës së matur- në kolegj ishte gjithnjë kështu, më thoshe, ju ishit e vetmja që nuk bëje kurrë shaka.

Gjetja e rrugës përmes një turme turistësh italianë, një çifti ketrash gri të ulur çuditshëm në barin e vjeshtës për t'ju parë ju tek kalonit, dhe unë mund të lexoja në hapat e tu të gjatë dhe në mënyrën si e mbanit trupin, hiret e një gruaje të edukuar, si të gjesh rrugën, si të kërkosh një botë impulsive, të qëndrueshme, të ngadalshme pa fund, ju asnjëherë nuk flisnit me njeri, as me mua, megjithëse e dije se mundeshe.
Zëri yt ishte i qëruar nga cigaret franceze dhe filozofia e shekullit 20, ju e shqiptonit emrin tim si të ishte një parfum, me kujdes në fillim, pastaj fort, Xhorxh… Xhorxh… si një valë e bardhë e blu e pëllumbave që ndaheshin përballë nesh dhe unë rashë keqas në ty, tek çdo pjesë e trupit tënd, hapave të tua, vendosmërinë tënde, mënyrës si më tërhiqje rrugës duke qenë edhe më e gjatë se unë dhe me një theks perfekt.

Supet e tua i fshihnin yjet në qiell, në një rrymë të kundërt me vjeshtën, do të thoja, nën tendën e pemëve, gjetheve të vjeshtës që kishin filluan të binin, në rrugën e tyre drejt harresës, degët e qershive të egra që kolovitesshin në parandjenjë të kalimit tënd, jashtë në rrugë, shitësit e tezgave bërtisnin ndërsa ju donit një kafe dhe ne u ulëm dhe ju hoqët shkujdesshëm xhaketën nga supet.

Çfarë po prisja unë, Nirvana?

Sytë e tu u vogëluan dhe ju kishit veshur një këmishë nate të bardhë, një dhuratë nga babai, më thatë, ai e kishte blerë në Paris, ishte puna e tij për ta ditur çfarë ishte e modës, shija e tij do të bëhej gjithnjë më vonë juaja- po, ajo ishte një bluzë e zgjedhur, ishte një qasje e qëllimshme e juaja për ta afruar trupin përpara për të më puthur.
Kjo ka kuptim kur bëhet ngadalë, më the, qëllimisht, si një premtim, si një fshehje, si një lutje.

Përktheu: Kujtim Morina

ABEL D ‘ANDREA
(PORTO RIKO)

Abdel D’Andrea u lind me një emër tjetër. Kur ishte fëmijë, nëna e tij i tha që kishte prapanicën e çeliktë sepse mund të priste fundin e çdo grindjeje duke dalë me hije. Momentalisht është vetëm një qenie njerëzore e ngatërruar me përkufizimin e njerëzve. Ka një kopsht shtëpie. Është tifoz i WWE-së. Është babai i fëmijës më të bukur në botë. Mërzitet kur i thonë që nuk duhet t’i mësojë fëmijës që çdo njeri është familje. Do t’i bashkohet çdo grupi artistësh që dëshirojnë ta abuzojnë. Ka kush e quan ekscentrik. Në vendin e tij njihet me disa nofka, mes tyre “The Best Writer” (Shkrimtari më i mirë), “Dr. Warning” (Dr. Paralajmërim) dhe El Guanmanchou (One Man Show - Shou i një njeriu të vetëm). Shkruan kur i shkon mendja. Është autori i Todo Tiene Polvo (Gjithçka është pluhur), një libër nga dëshiron të bëjë njëmijë tirazhe. U përkushtohet vizitave në shkolla dhe burgje për të bartur poezi në atë vende ku kanë më shumë nevojë për të. Dhe urren biografi.

Paralajmërim! Paralajmërim!
Kemi tërhequr një kufomë për gjysmë mijëvjeçari!
Këmbët tona marshonin me ritmin e atyre
zinxhirëve injorance
që tërhiqnin të parët tanë në dhe!
Një populizëm pa mend na ka blerë me vetëm
një palë këpucësh
dhe na ka larë fytyrat me ungjij mashtrues, që na rrihnin
me fshikullimë në nënshtrim!
Sistemi ynë arsimor po çalon!
Kemi gërryer kulturën tonë në tekstin të pakripë dhe
lexim gjysmë-gomar!

Na kanë luajtur si violinë me tinguj që nuk kanë kuptim!

Kush do të guxojë të zgjojë nga dremitja
një ndërgjegje të burgosur për aq gjatë?

Paralajmërim! Paralajmërim!
U la jashtë njohuria reale nga ekuacioni informativ!
Nuk ka mënyrë tjetër ta quash përveç tradhtisë!
Nuk ka rimë, nuk ka arsye!
Një vend nuk mund t›i mbyllë shkollat kur në çdo stinë shkollën e lënë më shumë!
Qenka fytyra jonë që po lihet pas dore,
E ke parasysh... Fëmija e varfër që nuk i hap sytë dot si duhet
Për indoktrinimin e tanishëm arsimor!
Po aman, çka po pret? Kujtimet janë ende të freskëta!
Vëllai i tij, i vdekur në pragun e trotuarit!

Nuk qan sepse nuk ka frikë.
Ka njerëz të cilët i shikon, toka e premtuar është e afërt,
grumbuj admirimi nëse arrin t›i përmbajë lotët!

Po pse fisnikët në vendet e larta
të vrasin mendjen gjysmë muti për atë që fëmijët ballafaqojnë?
Kush kujdeset për mësimet e xhunglës prej betoni?

Paralajmërim! Paralajmërim!
Mendjet tona janë të kyçur në një labirint burokratik!
Jemi të ngrirë, të tronditur, ngurrojmë të besojmë që ka një rrugë tjetër!
Hapim gojët tona si dele që blegërijnë,
një mi i zënë, duke përsëritur fjalimet e njëjta,
programimin e njëjtë që na çon në thertore!

Ndërkohë
empatia po zvogëlohet.
Besimi po zvogëlohet.
Ndërgjegjja po zvogëlohet.
Shpresa po zvogëlohet.

Sepse kemi qenë të gjithë të robëruar,
dhe askush s›do të na shpëtojë
përveç teje.

• • •

Nuk jemi njerëz,
Vetëm tregime.
Askush s›është i rëndësishëm.
Kurrë nuk ishim të rëndësishëm.
Kemi kapur një rol për të përligjur ekzistencën.
Mezi qese prej lënde organike që gërvishtim dheun e pistë,
të rregullohemi me aq sa kemi, dhe kudo mundet, të shkojmë me rrymën.
Nuk ka kryengritje.
Askush nuk i mëson skemat
Ose i merr vesh drejtimet.

Nuk jemi njerëz.
Nuk kishim kurrë një shans për të kuptuar plotësisht se çfarë është jeta.
Duhet të brengoseshim për mbijetesë.
Disa duhet të lypnin ose të poshtëroheshin.
Disa gënjyen, u bënë kriminelë
duke jetuar në kohë të huazuar.

Nuk jemi njerëz.
Vetëm visheshim këto maskime
në përpjekje për t›u përputhur si një gjëzë me pjesë munguese.
Fjalëkryq me fjalë të dobëta.
Shaka me shije të keqe.
Miti i një unaze të artë nga tunxhi.
Bar i keq që mbin në çarjet e betonit.
Vetëdije e një mendjeje të uritur në koma.
Të pafajshëm, të pacipë, të pambrojtur.

Nuk jemi njerëz.
Bagëti për të majmur të arriturit,
që fituan luftërat e tyre,
rrëmbyen tokën, dhe sot ushqehen nga ëndrrat tona.

Nuk jemi njerëz.
Nxitim sheqeri që shtyn mendjet tona.
Besimtarë patologjikë.
Imazhe pasqyre mezi të ndryshme, që në thellësi janë njëlloj.
Pika të veçanta uji nga rrebeshi i njëjtë.

Nuk jemi njerëz.
Jemi numra.
një murtajë, parazitë,
gurë mbi një tryezë shahu,
një virus që përhapet nëpër planetin,
eksperimente shoqërore, minj laboratori, majmunë në kopsht zoologjik,
përbindësha të mallkuar cirku.

Nuk jemi njerëz.
Gjithmonë e njihnim.
Për një çast ishim këtu, dhe në tjetrin...

• • •

Gjithçka është e pistë.
Ndaj nganjëherë duhet t›u heqim pluhur shpirtrave tanë.

Të lirojmë nyjat që na lidhin me absolutet më të rënda
dhe të fluturojmë larg kufijve të logjikës dhe arsyes.
Të shkëputemi nga turmat dhe jetojmë.
Të prekim kufijtë e pagdhendur të përgjakur të çmendurisë sonë
dhe të ngrihemi edhe më tej,
të shtyjmë kufizimet, të lëshojmë mendjen,
të shqyesh tërësinë tënde madje nga vetja jote.
Se një herë kjo s›do të jetë një barrë e rëndë, ky akt i tmerrshëm i mendimit.

Ka kohë kur ndiej që nuk i përkas kësaj bote.
Ashtu si ti.

Edhe filtri në thjerrëzën time është i njollosur.

Gjithçka është e pistë
Ndaj nganjëherë duhet t›u heqim pluhur shpirtrave tanë.

Se për një kohë aq të gjatë kam kërkuar një përgjigje të thjeshtë
Që kërcen në ekzistencë nga ajër i hollë,
zhytet në qoshet më të thella të kësaj mendjeje të pafund krijuese.
Nuk dua më ta citoj autoritetin dhe ta vë në pyetje,
nuk dua më t›i ndjek të tjerët, por të vendos për rrugën time.

Gjithçka është e pistë.
Duhet t›u heqim pluhur shpirtrave tanë herë pas here.

Kam parë fundin e të gjitha këto gënjeshtrave,
zinxhirët që më lidhnin poshtë para se të ikja.
Shtegtoja, duke u penguar, mbi shkrepat e një lirie që ende nuk arrija dot
edhe kur uni im më tërheq për në greminë,
po rri më këmbë,
mbaj lart kurorën duke ngritur shpirtin dhe pritur që perënditë t›i përgjigjen thirrjes.
Duke ditur, linda i numëruar dhe më kërkohet llogaria për pasionin më të paqëndrueshëm,
I farkëtuar të jem një pasqyrë e urtë.
Një reflektimi i thyer, i shtrembëruar i të gjithë këtyre «unëve» që më formojnë së bashku,
të shkrirë në atë platformë tejmoderne përjetimi.
Pluhur yjesh, që grumbullohet mbi male dëshpërimi,

Kështu bërtas dhe ulërij derisa të na dëgjojnë shtypësit tanë.
Mjaft! Nuk e pranoj më!
Largoni prej meje gishtat tuaj tregues!
Nuk do t›i jap më asnjë hapësirë fajit tuaj!

Gjithçka është e pistë.
Nganjëherë duhet t›u heqim pluhur shpirtrave tanë.

MIGENA ARLLATI
(KOSOVË)

U lind më 6 shtator 1974, në Elbasan (Shqipëri).

Pasi kreu shkollimin fillor e të mesëm në vendlindje, po aty vazhdoi Universitetin "A. Xhuvani", Fakulteti Filologjik, dega gjuhë shqipe e letërsi. U martua me një djalë nga Gjakova, qytet në të cilin jeton prej 23 vjetësh.

Për një kohë të gjatë ka punuar në mediet kosovare: në Radio Amadeus, në Tv Syri Vision dhe në gazetën "Lajm Ekskluzive".

Pas një periudhe dhjetëvjeçare në gazetari, u rikthye në profesionin për të cilin kishte studiuar, mësimdhënëse në gjimnazin "Hajdar Dushi" në Gjakovë, si dhe ligjëruese në Universitetin publik të Gjakovës "Fehmi Agani". Përveç letërsisë, një fushë me shumë interes për të janë studimet gjuhësore, ku ka mbrojtur titullin "magjistër" në temën: "Vështrim në frazeologjinë e të folmes së Gjakovës".

Në vitin 2015 u shpall Qytetare Nderi në vendlindjen e saj në Elbasan ndërsa në vitin 2016 mori titullin "Albanian Excellence" në Tiranë.

Gjithashtu, është kryetare e Lidhjes Ndërkombëtare të Poetëve, Shkrimtarëve dhe Artistëve "Pegasi" Kosova dhe nënkryetare e "Pegasi" Albania. Aktiviteti i saj është i vrullshëm edhe në shoqërinë civile, pasi drejton Fondacionin e gruas intelektuale "Nermin Vlora Falaschi" në Kosovë. Disa herë është nderuar nga institucionet me çmime të larta në punën e saj si gazetare, poete dhe aktiviste e shoqërisë civile. Me punimet e saj shkencore në lëminë e gjuhësisë është prezantuar në Konferenca e Simpoziume të shumta brenda dhe jashtë shtetit duke

dhënë kontributin e saj të çmueshëm.

Deri tani është autore e gjashtë librave:

- Mendime në kornizë (100 poezi) - Prishtinë, 2012
- Lindur për t'u bërë mjek (monografi kushtuar mjekut R. Lila) - Gjakovë, 2013
- Vështrim në frazeologjinë e të folmes së Gjakovës - studim gjuhësor, Gjakovë, 2014
- Patronimet (mbiemrat, emrat familjarë) në Gjakovë - studim gjuhësor, Gjakovë, 2015
- Etern' Ars - kritika letrare, recensa, ese, Gjakovë, 2016
- Autorë të letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj (1886-2017)- (leksikon në bashkautorësi), Prishtinë, 2017

BREG

Me këmbë zbathur
e trup të lagur,
vesh me yje natën
ngjyros me diell perëndimin,
ëndrrën merr mbi supe
aromë gëzimi përhap tutje,
më vjen si hap i lehtë
nga qielli zbret edhe retë,
zbut dallgën e pabindur
shkrin zemërimin e hidhur ...
Aty më bëhet të rri
natyra dhe unë të shkrirë në Nji!

DËSHMI

Ajri e pa
lumi e ndjeu
sytë heshtën.

Asgjë tjetër s'ndodhi!

Gjurmët fshihen në qiell
shpirti mbet nën dry
heshtja gjithmonë aty!

E PARA

E para ishte fjala.

Ne
e hëngrëm.
E për(punuam)typëm
në manifaktura rrenash!

JONIT

Bëhem Narcise sa herë vij tek ti
i kthjellti, i freskëti deti Jon,
si një guaskë e vogël zhytem në thellësi
të shoh si me qiellin kaltërsinë rivalizon!

Pasqyrë që reflekton çdo gjë që sheh
smeraldet nuk janë më të pastër se ti,
sa ishuj, ngushtica, anije ngashnjen
e zemrat e pushuesve përmbledh në gji.

Të dua o det me gjithçka përreth
brigjeve të tua shkel unë pa nda,
dhe s'kam asgjë tjetër në këtë tokë
veç ty dhe ëndrrat anës matanë.

Përqafohem nga dallgët e tua,
përkëdhelem me rrezet e diellit,
fundësinë e errët ta dua
rërën, dhe kripën mbi lëkurën e njelmët.

I mbyll vargjet e mia në një shishe
e gjuaj andej nga valët kërcejnë,
dhuratë për ty Jon i kaltërsive
ëndrrën time në zemër mbaje thellë!

ANTON BAEV
(BULLGARI)

Anton Baev (1963) është autori i shtatë librave me poezi, katër romaneve, një libri me fragmente filozofike, dy librave me tregime të shkurtra dhe dy studimeve: për romantizmin dhe për sindromën e vetëvrasjes në letërsi.

Ka doktoruar për letërsi bullgare (2009) në Akademinë bullgare të Shkencave.

POEZI

Përmbledhja e parë e Anton Baev-it me poezi Sinjale dëbore (1988) u shpërblye me Çmimin kombëtar për debutim letrar.

Vijuan Shpina e errësirës (1991), Kalorësi, Nata dhe shkretëtira (1995) dhe Kryqëzimi i Odaegithries (1998). Kritikët karakterizuan përmbledhjen e tij me poezi të zgjedhura Gjithë bota dhe apokrife të tjera (2002) si përpjekje të parë letrare për të përcaktuar një model qytetërimi në poezinë kombëtare bullgare që ka Mesdheun si qendër kulturore dhe topografike.

Disa e krahasojnë poezinë e tij me shembullin kulturor të Kavafis-it të madh.

Më 2004, Anton Baev botoi përmbledhjen e tij të poezisë Dhuratat e botës. Apokrife të reja, që vazhdon eksperimentet e tij për të dramatizuar mitologjinë dhe historinë, si dhe për të krijuar mbi këtë bazë një shprehje moderne poetike.

Më 2012, libri i tij më i ri i poezisë Ditarët e të dëbuarit u shpërblye me çmimin letrar "Plovdiv".

PROZË

Anton Baev është autori i romanit Amerikanët (1997) dhe i librit me fragmente filozofike Arka e Noes (1999). Më 2005., botoi një libër me tregime të shkurtra, "Femra

dhe planete", që u përkthye në turqisht.
Romani Vurata nga një bullgar (2006) u shpërblye me çmimin letrar "Plovdiv".
Më 2010, Anton Baev botoi studimin e tij për poezinë dhe dramaturgjinë e Ivan Peychev-it (1916 – 1976) dhe romantizmin bullgar.
Po ashtu më 2010 u botua libri i dytë me tregime të shkurtra, Viktor Bullgari, që merret me jetën e emigrantëve nga Ballkani në Gjermani. Do të botohet në Berlin në vitin 2017.
Më 2011 një libër me poezi të zgjedhura, Dunya Nimetleri, nga Anton Baev u botua tek Istanbul: Yasakmeyve.
Më 2014, Anton Baev botoi romanin e tij të tretë, Mos prit ndonjë parajsë tjetër, që u zgjodh si njëri nga romanët më të mirë bullgarë të vitit.
Më 2015, doli studimi i tij për sindromën e vetëvrasjes në letërsi, Sindroma e vetëvrasjes dhe heronjtë e Pavel Vejinov-it, i sponsorizuar nga Ministria bullgare e Kulturës.
Romani i tij më i ri, Gjaku i shenjtë, fitoi konkursin mes 116 romanëve bashkëkohorë bullgarë dhe do të botohet në fund të vitit 2016.
Disa nga veprat e Anton Baev-it janë përkthyer në anglisht, gjermanisht, turqisht, spanjisht, greqisht, shqip, serbisht dhe rusisht.
Librat e tetë poetëve dhe romancierëve bashkëkohorë turqë janë botuar në bullgarisht nga shtëpia botuese e Anton Baev-it. Mes tyre janë Yozdemir Ince, Hilmi Yavuz, Ataol Behramoglu, Enver Ercan, Yozdjan Karabulut, Ferridun Andach, Tozan Alkan dhe Jale Sandcak.
Ai është fitues i çmimit letrar "Oeneumi" të FNP "Ditët e Naimit".

DUKE LUAJTUR ME TULLA-LODËR

Antonias

Është sikur të luash me tulla-lodër,
Kjo ndërtesë e mendjes së madhe.

Fëmija e shikon e habitur,
E prek me një gisht
Ja ku shembet para këmbëve të vogla.

Fëmija qesh në mënyrë çarmatosëse -
Një barbar në mes të rulave katrorë.

(Nuk kam dëshirë të luaj me tulla-lodër,
Mirëpo, e tëra që dua është të shijoj t'i kem.)

NGA "TË DIELA"

8.
Ata që kanë parë gjithçka
Dinë që nuk kishte kuptim.

Ata që kanë dëgjuar gjithçka
Dinë që nuk kanë kuptim.

Ata që kanë përjetuar gjithçka
Dinë që nuk ka kuptim.

Atëherë, çfarë paska kuptim, pyesin ata
Që kanë parë, dëgjuar dhe pësuar gjithçka?

Kjo qenka pyetja e shtruar nga të gjithë
Që janë kthyer për në fillim.

26.
Ka kohë për të dhënë
Dhe ka kohë për të marrë.

I bekuar qoftë ai që jep
Pa marrë!

I bekuar qoftë ai që jep
Ndonëse ka marrë!

Dhe kushdo jep duke mos pasur gjë,
Përkulu para tij!



SILKE LIRIA BLUMBACH
(GJERMANI)

Me, emrin e saj shqiptar Liria, u lind më 13 dhjetor 1970 në Göttingen, Gjermani, në një familje mësuesish. Filloi së shkruari poezi në moshën 8 vjeçare dhe mori pjesë në një klub letrar në Heidelberg. Mirëpo, depërtimi i saj erdhi vetëm pasi mjeshtroi gjuhën shqipe. Si e huaja e parë që shkruante shqip, ka botuar tre libra me poezi dhe një ditar në gjuhën shqipe, si dhe një libër me poezi në anglisht.

- Dyzet vdekje në Sarandë, Tiranë 1999
- Karavela e fundosur, Tetovë 2002
- Lumi që rrjedh drejt burimit, Tetovë 2007
- Ditari i një kthimi, Tiranë 2010
- Beyond the Bows of the Heart, SHBA 2012

Poezitë e saj, që u botuan në revista dhe gazeta letrare të vendeve të ndryshme, duke përfshirë revista interneti, u përkthyen në boshnjakisht, rumanisht, odia (një gjuhë e Indisë) dhe kinezisht, ndërsa ajo ka shkruar edhe poezi në frëngjisht, spanjisht, gjeorgjisht dhe hungarisht. Ka fituar një sërë shpërblimesh letrare, veçanërisht, por jo vetëm, në botën shqiptare. Është anëtare e Drejtorisë së Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë "Ditët e Naimit"në Tetovë.

Fjalët janë edhe në qendër të jetës profesionale të saj si përkthyese. Ka përkthyer libra të poetëve nga gjuhë të huaj në gjuhën shqipe.

Jeton në Berlin, ku punon në një ndërmarrje të madhe përkthimesh.

Prej gushtit 2014, lufton me kancer të gjirit me metastaza në mushkëri dhe në eshtra.

MACEDONIA I

Në autostradën e Lekës së Madh
tri mace kanë dhënë
ofshamën e fundit.

Tri mace të kuqërremta
të shtypura nga rrotat e kohës
shohin lotët e malit në ëndërr.

Do të vijë koha
kur të gjitha tregues të rrugës
do të jenë mace të shtypura

të kuqërremta si zjarr.

MACEDONIA II

tri mace
të shtypura
në rrugë
dhe një mal
që qan

të mirëpret Macedonia
me gëzof të përgjakur
kuq e verdhë
dhe një mal të grabitur
me mbresë të ngurtë

i gjelbërt
është vetëm ilaçi
që nuk ngop

DHIMBJE KOKE

kam dhimbje koke

të ndjek
këshillën e vrasësit?

„shqiponja me dy koka jemi
dhe kur na këpusin njërën
mbijetojmë me tjetrën"

po kokën rezervë
ku e lashë?

mos e keni parë?

HARTA E LËKURËS

një mbresë e drejtë mbi gjirin e djathtë
një tjetër të drejtë nën sqetull
për të vazhduar këtë jetë uthulli dhe hiri

një mbresë e vocërr mbi mbarkun
për të mos rënë viktimë
e biologjisë femërore

një mbresë e rrumbullaktë
mbi gjirin e majtë
në saje të barazpeshës

njëra nga operacioni i dështuar
tjetra nga operacioni me sukses
pranë zemrës kam një kuti të fshehtë

kaq për hartën e lëkurës sime
nuk përmend mbresën mbi kyçin e dorës së majtë
as ty s'do ta tregoj

se vdekja nuk do të më vijë më
nga dora ime e djathtë
se koha ndryshon

pabesueshmërisht…

LEXOJNË POEZITË

Si çdo herë
nuk kemi die
se si do të kalojë
kjo mbrëmje poetike.

Jemi të ulur në karriget
si të paditurit në gjyq
vetëm që neve na gjykojnë
vetë poezitë.

Ato nuk na kanë treguar
se kush prej tyre do të dalë në skenë
për ta lexuar njëra-tjetrin
dhe cila, më në fund, do ta lexojë poetin.

Kjo është e veçanta e këtij festivali
prandaj vijnë mysafirë nga të gjithë meridianët
për t'i parë poezitë që lexojnë poezi
dhe poetët që lexohen nga krijimet e tyre.

Me frymë të mbajtur e pres radhën
dhe shoh se si del në skenë
me duartrokitjet e poetëve dhe poezive
poemthi im „Barka e vogël e historisë".

Kjo poezi nga përmbledhja ime e fundit
ka zgjedhur një simotër për lexim
nga libri im i parë fare:
„Moskomunikim".

Kjo ka kuptim dhe kjo ka lidhje:
komunikim nuk ka, ndaj s'ka shumë histori.
Ah! U lehtësiva, por vetëm për një çast,
sepse e treta do të dalë e vërteta.

E treta poezi ka për të më lexuar mua.
Jetë a vdekje. Dënim a lirim.
Poezitë bashkë me poetët prehin veshët
dhe unë nga emocioni thyej stilografin tim.

Më në fund thirret dhe emri im, dhe çohem.
Menjëherë më dhembin dhëmbët fuqimisht.
Nga qoshet e buzëve mundohem të buzëqesh, por kot,
se poezia që më lexon më dënon me titullin e vet:

PIERFRANCO BRUNI
(ITALI)

Është lindur në Kalabri. Është drejtor Arkeologjik i ministrisë së kulturës trashgimore, formalisht pjestar i Komitetit të UNESCOs për difuzionin e kultures italiane jashtë vendit, është udhëheqës i Qendrës së Studimeve "Grisi". Ai gjithashtu ka detyra të shumta institucionale në lidhje me promovimin e kulturës dhe literaturës në shtetet e huaja. Ai është përgjegjës për projektin e studimit për Prezencën e Minoriteteve nëw Itali në emër tëw MiBAC.
Ai ka botuar libra me poezi (duke përfshirë "Via Carmelitani", "Traveling Island", "Do not Love You anymore", "Moonlight Fire", "Requiem Song", "Ulisse is broken", "I'll love you" asleep in the red of your afternoon "), tales and novels (including" The Last Night of a Magistrate "," Country of the Wind "," Claretta and Ben "," The Last Spring "," And then came dreams, "" When the rocks bloom, "" The sea and the shell "). Ai ka qenp i pprfshirp në Italianin e shekullit të 20, literaturën Europiane dhe Mesdhetare. Ai është përballur me literaturën e shekullit të 20 me librat Pavese, Pirandello, Alvaro, Grisi, D'Annunzio, Carlo Levi, Quasimodo, Ungaretti, Cardarelli, Cat, Pen, Vittorini etj.

SIKUR TË ISHE TJETËR DHE JO DASHURI

1.
Po të ishe ndryshe nga ç'je;
ndoshta flutur ose shqiponjë; dhe unë s'do të isha
ky që jam;
vjeshtë apo përhumbje. Do të jetoja një jetë
më shumë a më pak
që të mos e humbja në një dhomë
gjithë erën që m'i mbylli duart.
S'do të të dashuroja vetëm për dashuri;
por do të të bëja pafundësi të festave.

2.
Ti ishe udhëtarja
e shtegtarëve në arrati
ditën kur qielli
u shndërrua në hënë, prej balte gatuar.

3.
Pastaj lundrove nëpër shpirtra detesh
mes shkëmbinjsh të fatit.

Tash ishulli yt ka sytë e Kalipsit
por jam unë ai
që kurrë s'humba dhe s'mungova
në jetën tonë mes erës së dallgëve.

Ti je lundruesja e arratisjeve të mia
ndërsa unë udhënisja në vetminë e portit.

Udhëtimi?
Mos i kërko udhëtimit të bëhet nisje o kthim.
Jetoje si këngën e Askushit.
Do ta kesh si perëndimin në një klesidër.

Në erën e shqiponjave
horizontet janë Mesdheu i Lindjes.
Tirana luan me mua mes zërave
muzgjet e agut.

4.
E dëgjova erën e detit të grave me vello
Ndër duar.
Mesdhetarët janë ngjyra
Dhe arrati ndërsa ushëtimi që i bashkon kthimet.

Përtej kufijve

fjalët bëhen të gjata.
Vrojtoi vetëm
nga kjo anë.
Është e njëjta orë si dje.
Montekarloja është një copë
Që i ka ylberet
Në erën e balonave.
Festë do të kemi
Në detin e valëve të tua.

5.
Dëgjomë derisa të përhumbem në horizonte.
Më pas s'do të jem më.
Gjeje ti si të më gjesh
sepse kërkimi është i pamundur.
Ashtu si era që plagos një përrallë
do të qëndroj i patundur
i papranishëm mes reve dhe hijeve
por pranë largësive të lundrimeve të tua.
Do të më gjesh pa më kërkuar.
Dita do të të duket më e shkurtër
njëlloj sikur të më shohësh në sy
në një mëngjes me shi në oborr
poshtë pemës së fëmijërisë



POUL LYNGGAARD DAMGAARD
(DANIMARKË)

I lindur më 24 dhjetor 1977 në Randers, por u rrit në Odder. Jeton në Aarhus, Danimarkë. Kryen gjimnazin në Odder më 1997 dhe mbaron studimet si mësues për gjuhën daneze dhe artet pamore në seminarin Skårup më 2004.
Poezitë e tij përmbajnë imazhe fragmentare që kuadrojnë ndjenja të ndryshme. Pejsazhe ëndrrash të qytetit dhe mendjes.
Poezitë janë botuar në disa antologji skandinave dhe përmbledhje daneze poezie.

PASQYRA E HOLLË NË ERË

Autobusi ndalet në rrugë lart në kodër
dhe shkon ngadalë poshtë në mal.
Do të arrinim në majë por rrëshqasim më poshtë.
Të gjithë duan ta ndjekin rrugën.
Një gotë ujë
po pihet pranë shkurres
që rritet e egër. Nuk ishte fara në dorën time
që do ta mbillja,
por gjithsesi e bëj. Me magji ti më lidh me ndonjë
gjë tjetër.
Rrezet e diellit arrijnë funddetin.
Një ajsberg që shkrihet nën sipërfaqen e ujit.
Dallëndyshja fluturon nëpër letrën.
Ka yje në anën e pasme.
Duarve të mia u mungon shkrimi me dorë.

Një faqe e hapur mali dhe një jehonë
janë pyetjet e paletës së bojës.
Kundër majës shohim veten tonë të riprodhuar
në sipërfaqen e imazhit në ndryshim.
Askush nuk arrin pa njohur pasqyrën e hollë në erë.

VIJAT ME TULLA MBI UJËRAT

Në këtë natë askush nuk do të lundrojë, dhe dora do ta udhëheqë lapsin
mbi letrën dhe do të vizatojë një barkë të braktisur në mes të liqenit
me rremat përgjatë anëve të përgjegjshëm për valët.

Gjatë ditëve të ngasjes i mituri shpërthen
mbi një mur dhe vjell ilustrimin
në një pemë që lëkundet nga njëra anë në tjetrën
pranë udhës larg dhomës.

Këtu askush nuk jeton larg detit,
dhe dora bën një skicë të re
në anën tjetër të ujit.

QYTET I DASHUR

Dua të tregoj për boshllëkun midis shtëpive dhe mënyrën se si dritaret janë përtej të gjitha. A di diçka për këtë? E njeh mënyrën se si lagjet u tërhoqën në një tel nëpër vetëdijën tënde, dhe grupet e njerëzve shfaqin në periferi të një zone? Nuk jam i sigurtë nëse e njeh. Nganjëherë zinxhiri i palltos sate është një autostradë poshtë kodrës dhe ti më kthen shpinën, e hedh pallton, kërcen në ujë dhe largohesh me not. Shkëlqimi i flokëve të tu të gjatë dhe të lagur është drita e hapësirës së ndriçuar të natës. Në qoshen e rrugës kryesore, ku dikur gjendej shtëpia e shkujdesur pa dritare, u vendos një barakë, ku boshllëqet dhe kujtimet e ndërtesave u shiten turistëve. A ishte vërtet vëllai yt i panjohur apo a ishe vetëm ti në sytë e të cilit shikova atje?

Shumë të fala
një shtëpi

MUNDIM I PËRBASHKËT

Xhazi është një dhomë, por edhe i përket një dhome. Domethënë, edhe ne ishim këtu
natën e fundit. Mizat fluturuan përreth qoshes dhe unë hapa një derë. Pemë të bardha
mbi një fotografi rëntgeni. Një statuje me sy të lidhur. Dëshira të shtruara me pllaka
Në një dhomë të hapur. Insekti ndërron drejtimin e xhamit mbi të cilin u vizatuan shënues.
Një shtëpi e sonduar, dhe ti nxjerr identitetin tim nëpër tëndin duke u endur në një motiv diellor.



RIKI DASKAL
(IZRAEL)

Riki Daskal u lind në Haifa, Izrael, në vitin 1953.

E mbaroi Universitetin e Tel-A-viv-it me «Bachelor of Arts» (BA) me specializim në studime teatrore dhe letërsi. Studioi edhe pedagogji në Universitetin e Haifa-s dhe mbaroi me «Master of Arts» (MA) për studime hebraike në Institutin «Schechter».

Më 1985, poezia e saj u botua për herë të parë në një revistë letrare izraelite dhe prej asaj kohe vepra e saj vazhdon të botohet në disa revista letrare dhe në gazetat e përditshme.

Deri më tani u botuan gjashtë libra poezie nga Riki Daskal:

Një vijë drite, 1989
Të gjithë kanë mall për një gjest dashurie, 1993
Kujtime zorrësh, 2000
Bukë tempulli, 2007
Aftësia përfytyruese, 2012
Siç është, 2016

Riki Daskal është laureatja e Garës Izraelite Alef për Poezi dhe Prozë 2000.

Më 2012 mori çmimin izraelit ACUM për Inkurajimin e Botimeve Krijuese.

Riki Daskal ishte mësuese letërsie në shkollën e mesme për 15 vjet, ndërsa në 17 vitet e fundit u ka mësuar shqiptim dhe diksion studentëve të teatrit.

Në vitet 1970 dhe 1980, Riki Daskal luajti në disa teatro në Izrael. Në vitet e fundit u shfaq në skenë kryesisht në projekte letrare dhe në projekte në bazë të veprave të saj.

Riki Daskal është e martuar, është nëna e katër djemve dhe gjyshja e katër nipërve.

HIJESHI

Rëra është një mrekulli
Jam e ulur me këmbë të kryqëzuara
Në pamjen time gishti i Zotit tringëllon
Edhe një monedhë e artë në kutinë e mbledhjes
së kohës
Po të guxoje vetëm të ishe një diell
Po të guxoja vetëm të isha një det
Do të fitonim një çast të përsosur
Të mosdijes.

DHE NJË PALLUA FLUTURIMI I TË CILIT E MBULON QYTETIN

Si t'i bëj fjalët e mia
aq të rënda sa parfum
aq të tensionuara sa një mace në gjueti
të vetmuara si një kamion
fjalët që zëvendësojnë pëlhurën dhe bojën
terpentinën dhe penelat
modelet, picërimin e syrit, hapin mbrapa
Mund të pikturoja fjalë të gjelbra me gishtërinj tymi
çdo portret të gdhendur në zemrën time
çdo shtëpi, çdo hije zgjatëse të një peme
çdo gur që pashë, guralec apo shkëmb
çdo fëmijë me kapakë syri si flutura dhe me bark
si lule
çdo fitil qiriu
çdo re
çdo gjethe që pashë nga dritarja ime
këngën e zogut dhe çdo vezë
që, si dielli, do të kërcitet hapur çdo mëngjes
prapë e prapë

UNAZA E SZYMBORSKA-S

Flokët e saj të hollë si puplat e një kukuvriqi të ri,
buzëqeshja e saj e pamundur për t'u pikturuar
rrudhat e saj në bisht të syve si këmbët e një zogu
magjik, fytyra e saj një jorgan që ajroset në pezulin e
dritares
Por unë, një kafshë pylli e mbledhur kruspull për t'u

sulur, për të kapur shikimin e një unaze modeste diamanti në
gishtin e saj artritik. E njëjta unazë, tamam e njëjta unazë që e ka nëna ime
bashkëkombësja e saj, gjuha e saj amtare,
mosha e saj.

Po të ishte nëna ime, do të trajtohesha më mirë se ata që rrotullojnë emrin e saj
në gojët e tyre sikur të ishte rrush i ngrirë dhe ajo do të ishte ende e gjallë.
E paracaktuar për t'u djegur në kujtimet e saj, duke luftuar me to natën, duke iu dorëzuar ditën.



ELKA DIMITROVA
(BULLGARI)

Elka Dimitrova (1971) është një shkrimtare bullgare, kritike letrare, përkthyese dhe dijetare - pedagoge e doktoruar në Institutin e Letërsisë në Akademinë Bullgare të Shkencave, dhe drejton shumë projekte letrare (Letërsia bullgare dhe moderne – 1, 2, 3; Modernizmi letrar bullgar - http://bgmodernism.com/ , Trashëgimia kritike e modernizmit bullgar etj.). Jeton dhe punon në Sofje.

Elka Dimitrova ka botuar tre libra me poezi (E qeshura e Pashkëve / Rhisus Paschalis, 1993; Rrethi, 1998; Në gjysmëterrin e mendimeve, 2008). Ka botuar një numër të madh shkrimesh në revista letrare dhe akademike (edhe në Bullgari edhe jashtë) si dhe në disa edicione letrare në internet (Slovo.bg, LiterNet.bg e të tjera): poezi, tregime, kritikë letrare, artikuj, studime, monografi dhe metoda. Mes përkthimeve të saj janë poezi nga T. S. Eliot dhe Marina Cvetaeva, poetë bashkëkohorë hungarezë dhe rusë si dhe një roman nga Edith Nesbit.

Elka Dimitrova ka marrë disa çmime për poezi, si ato kombëtare nga Universiteti Shumen, Javorovi Dni (Ditët e Javorovit), Dora Gabe, si dhe çmimin për poezi nga Akademia franceze e Arteve. Edhe pse botimi i librave poezie nuk është prioriteti i saj, shkrimi i poezisë është hobi i saj i pëlqyer.

xxx
A të kujtohet kjo verë,
kur mësuam për të jetuar -
jo nga pishat shekullore,
por nga fluturat njëditore.

xxx
E tunda litarin -
asnjë kambanë nuk kumboi.

xxx
Bota po mbyllet në veten.
Duart e orakullit po dridhen.
Heshtje në një guaskë.

SHTËPIA E LUMTURISË

mendoja që do ta gjeja -
shtëpinë ku kemi qenë
para aq shumë kohe dhe aq të lumtur pa arsye -
me moshën kënduese të rrezeve
dhe minjtë fushore në garë
dhe atë vetmi
të kryqëzuar midis qiellit dhe tokës -
mendoja që do ta gjeja...

Pashë një vajzë
që me ngathtësi të dashur shpalosi
mishin e vajisur të detit -

Shko, shko, është atje...

Dhe dy fëmijë që vënë zjarr
në rrëqethjet e shiut kalimtar -

Shko, shko, është atje...

E pastaj një çift pleqsh
që ngjishen në një përqafim të fashitur
ngrohtësinë e tyre të fundit -

Shko, shko, është atje...

Kështu ecja,
ndonëse e dija -
para shumë kohe pata kaluar
shtëpinë që nuk bie në sy,
të lumturisë sonë të dikurshme...
Por nëse fjalët duhet t'i
tregohen dikujt:

Mos u kthe,
Mos u kthe në vendet
e lumturisë së kaluar!

VENDI I HUMBUR

E prenë zemrën tënde rrënjë për rrënjë –
ajo kthehet në një kokë demi shkumëzues,
kthehet në një hetairë plake pa kujtime,
në një pllakë të plasur,
mështekën e gjakosur -
fruti i pemës dhe zjarrit...
Ti vdes, i kryqëzuar
në këmbët e shpërndara
të të Butit, që të konceptoi,
dhe kujtimi të përlan -
dëshira e një guaske
dhe jargë mbi rërën
mbi të cilën
do të ecësh...
Nostalgjia gdhend
hojet

e thembrave të tua,
gdhend
tejdukshmërinë e fundit të barkut tënd
dhe gjithçka të rrumbullakët në trupin tënd,
gati për ta strehuar...
Ti jep një dorë të tërbuar -
dhe dashuron, dashuron, dashuron...
Ti jep një qafë të tërbuar -
dhe ende dashuron...
Ti jep kërcinjtë e dobësuara
dhe fyellin e gjyshes sate flokëlehtë...
Jep të gjitha pa të cilat
nuk vazhdon dot,
ti çan pemën e jetës -
dhe lulëzuaka!...
Po horizonti
thith thundrat e verdha
dhe monedhat e tërbuara të arta të kuajve
tringëllijnë në xhepat e tyre hënorë
të prerë mbi ijët e tyre të majta

...ti shqyen vendin tënd të humbur
nga një ëndërr e jashtëzakonshme
dhe ai mbin në sedimentin e kujtimeve të tua
dhe është gjithmonë me ty
por nuk mund t'i tregosh askujt
plagën e asaj kafshe
në mishin tënd njerëzor
dhe dhimbjen e Zotit
në shpirtin tënd njerëzor.

SLLAVICA GAXHOVA
(MAQEDONI)

U lind më 1984. Është poete hulumtuese, përkthyese letrare, doktoresh e teorisë së literaturës. Është autore e librave me poezi "Infinity" (2001), "Letters" (2012), "Politics of Love" (2015), "Bodies" (2017), si dhe studimet "Letërsia dhe ligjëratat e pushtetit" (2013) dhe "Sensi dhe Absurditeti". Ajo hulumtoi ligjeratat e pushtetit dhe dhunën politike në literaturë. Në 2012 ajo u nderua me çmimin "Enhalon" në mbrëmjen Poetike të Strugës. Në 2016 ajo mori çmimin "Karamanov" për librin e poezisë "Bodies". Poezia saj eshte botuar ne disa antologji te poezisë bashkëkohore Maqedonase dhe eshte përkthyer në: anglisht, kinezisht, arabisht, çekisht, sllovakisht, serbisht, boshnjakisht. Ajo është themeluese dhe botuese e shtëpisë botuese Vostok. Ajo përkthen poezi dhe proza nga Sllovakishtja.

HATROGRAFIA E VETVETES

Në bebëzën e syrit
barti agimet dhe perëndimet e diellit
që i kanë sjellë nëna, babai,
gjyshja dhe gjyshi im
pastaj nënat dhe baballarët, gjyshet dhe gjyshërit e tyre
dhe të gjitha pulëbardhat mbi Detin e bardhë
edhe ato korbat e zi mbi Detin e zi
dhe të gjitha mjegullat mbi Detin e kuq
dhe Detin e vdekur me ëndrra të shndërruar në kripë
dhe plagët në vendin e flatrave
në vete kam edhe ujdhesë gjarpri
i kam në dy fytyrat e Isusit

dhe freskat e renesancës engjëllore
në vete barti një Olimp
me plot vetëtima në vete
që vetvetes i hedh bubullima

Unë me vete barti Saharën
dhe muzikën e Afrikës së veriut që e këndojnë burrat
që e këndojnë qelizat femërore
dhe të gjitha Babçorkat(1 ballkanike në mua
thërrasin një burrë të panjohur
dhe maje lartësish të panjohura, pa flamur,
humnera me thellësi dhe klithje me gjuhë të panjohur
kam kolendra dhe kaktus
një botë të trazuar dhe një lule të tharë
në një libër të lashtë me njohuri të fshehtë
që nuk di ta lexoj.

1.Babçorka- janë grup këngëtaresh gra

AFRIKANE

Më duhesh si zotëri i bardhë në mesin e njerëzve të zi
të të adhuroj si Perëndi
si Ekuatori që na ndanë për gjysmë
fatamorganë dhe dehidrim
për çdo vit hallkë e re në qafë
për çdo muaj vallëzim ritual
për çdo ditë vdekja të troketë në derë
për çdo natë barku të ngjitet për kurrizi
për çdo orë ëndërroje për bukë
për çdo minutë shfarosje të planifikuara
për çdo sekondë lindje të shumëzuara
më dukesh si nomad në shkretëtirën time
heretik nëpër rërë
gjej oazat
dhe atje shpërngulu si mëkatar

EMIGRANTËT

Katërmbëdhjetë veta pranë Velesit
i shkeli treni
trupat e tyre të zi ishin të pa dukshëm në errësirë
ballët e tyre u ngjitën nëpër binarë
fytet e tyre të vrazhda u venitën nëpër gurë
pluhur nga Hirami,Bonadiri dhe Mudugi
në poret e tyre
Kabulli dhe Heroti

avulluan pranë lumit të panjohur
zorrët e tyre të zbrazëta të derdhura nëpër binarë
i mbushën zorrët e kërmëngrënsve

ARSYETIM I RI

Më falni
por
kur të shpërngulem tjetërkund
me vete i marr të tri liqenet
dhe tokën rreth tyre
Qiellin mbi ato
mjegullat dhe
zogjtë shtegtar me ato
këngët nëpër fytet e tyre
rrugët e shkruara nën flatrat e tyre
dhe kthimin
e tetuazhuar me kodin gjenetik
të buzëqeshjeve të djeshme
dhe bukën e nesërme
ndaj për këtë shkak
kuferin e kam
kaq të rëndë

URIA E PAKUFISHME

E ushqej me gjakun dhe mishin tim
vetëm ajo ekziston
zmadhohet në çdo frymëmarrje
mbetet miniaturë
bile ajo edhe ritet
unë zvogëlohem
ajo zgjerohet
unë ngushtohem
ajo ndriçon
unë errësohem
as ngihet
as fryhet
unë zhdukem

RRUGA

Shumë çanta dhe valixhe
në një biletë të vjetruar
me një flatër pëllumbeshe
cilat nga ato t'i palos
në hartën për orientim të lehtë
me udhëzim për zbutjen e perceptimit poetik
nëpër kufij kalimesh
ku patjetër duhet të jesh i zgjuar
kur vulosen pasaportat
në cilën prej tyre ta palos
teorinë gjeopolitike të zemrës
e t'ia mësyj
Jugut-veriut
pastaj një vulë në pasaportë dhe një damkë në qafë
siç e kanë kafshët që theren për kurban

Përktheu: Remzi Salihu



SEMA GÜLER
(TURQI)

SEMA GÜLER u lind në Ankara në vitin 1971. Vjen origjinalisht nga Dersim dhe vazhdon studimet në Repartin e Historisë në Universitetin e Stambollit. Poezitë, shkrimet dhe bisedimet e saj u botuan në revista të ndryshme si Esmer, Yasakmeyve dhe Şiirden. Ka vizituar festivale, takime dhe kongrese në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Holandë, Irak, Siri dhe Gjeorgji. Poezitë e saj janë përkthyer në shqip, anglisht, kurdisht, arabisht dhe bullgarisht dhe janë përfshirë në antologji të ndryshme. Ajo është redaktore për arkeologji dhe histori arti në shtëpinë botuese "Hel".

Librat e saj:
Feyezân (2010)
Pema që zgjohet (2011)
Vdekja, fara dhe sendet / Pak dashuri (2014)
Nuk kam qiell (2015)
Trilogji (2016)

VDEKJA, FARA DHE SENDET

1-

O dashuri njëkohësisht më afër dhe më larg perëndive
E di që ka gjëra më të këqija se vdekja

I njoh nëntë bota
Pemë shëruese

Duhet të luftosh këtej; floku im kthehet në gjarpër
Sepse nuk i lashë dot fjalët që trupi im mbështillte dhe me të cilat Perëndia lodhej

Çɔtë bëj me ty tani,
Me stilin e ngjyrimit të një akrepi me shumë krerë që thahet për hakmarrjet në ballin tënd
në dhomat prej gurësh, dhe që gjithmonë kap armët e veta
Shiko, duke marrë nga thellësia jote të brendshme për matanë jetës,
E krijova kopshtin që vizaton kthesat nga vetmia e sinqertë të zogjve të penduar.

Sa larg më ke varrosur nga ti, o Zoti im!

2-

Kush më shkuli nga kjo ëndërr? (Nuk do të shëroj edhe një herë)
Në errësirë që vizaton hijen time mbi dheun, pa ajër pa lëvizje
U mbulova me krimin dhe ngatërrimin nga koka
në këmbë

Zogu që ende më këput me shpejtësi
dhe kërcen mbi vijën në kyçin e dorës në një çast
përfytyrimi i zbehtë në oborr

isha unë, pasi u zhvesha plotësisht nga qerpikët,
aroma e ujit që derdhet nga rëra, rrënja e mosbindjes
simboli i fundit që njohim si armik

As shkretëtirë
As erë
Po të ndërroheshin plagët e mia,
Do të mund të deshifroja dorëshkrimin e tigrit për të pyetur për rrugën

Ujërat dhe malet e heshtura ndryshojnë brenda nesh
Unë jam vajza e vdekjes, im atë është Parxhanja,
zoti i shiut,
I njeh të gjitha të fshehtat.
Fryma ime përzihet me zogjtë, loti im tërhiqet në guaskën e vet
Po dyshoj rrumbullakësinë e botës
Fustanit mendja e të cilit më mbulon me gjak, puplat dhe gurët ndryshojnë

Po kthehemi sepse kemi parë:
Eshtrat e një dashurie edhe thyhen pasi u varrosën.

3-

Magjia e hënës e së kaluarës, jade e shtrirë pas tyre
kulla e dritës e zënë cipë avulli dhe fortifikatat e një
kështjelle

Kalo me frymëmarrjet e tyre të holla prej pishe blu
kalo në mes të
hardhive frymëmarrjet e të cilave u ngjeshën me kërbaç
Perdet përqafohen me mall dhe përqafojnë këngët
A ishte një ëndërr
që ia dha peshën e vet fillit të kaltër të lutjeve
A ishte një varesë nga guri fenician që ra poshtë në
kalimet e ngushta
dhe qëlloi brigjet më të ngushta me furçën e
dashurisë?

Unë të lë mbrapa
me formën e një nate që e quajnë vdekje me kërcimet
e saj

Mos eja asnjëherë më

SHAIP EMËRLLAHU
(MAQEDONI)

U lind më 13 prill 1962, në Trebosh, Tetovë. Fakultetin Filologjik, Degën Gjuhë dhe Letërsi Shqipe e mbaroi në Universitetin e Prishtinës. Magjistroi në letërsi në Universitetin e Tiranës, në temën "Struktura e poezisë së Azem Shkrelit". Eshtë doktorantë i Letërsisë në Tiranë. Ai, është mësimdhënës në Universitetin Shtetëror të Tetovës.

Botoi vëllimet me poezi "Pagëzimi i viteve", 1994, "Projekti i thyer", 1997, "Vdekja e paktë", 2001. Më vitin 2001, "Akademia Orient - Oksident" në Bukuresht ia botoi në gjuhën shqipe dhe rumune vëllimin me poezi "Vdekja e paktë / Putina moarte". Në vitin 2004, PEN-i kroat dhe Shoqata e Shkrimtarëve Kroatë ia botoi vëllimin dygjuhësh kroatisht/ shqip, me titull "Poezi". Në vitin 2004, Sh.b "Feniks" nga Shkupi ia botoi në gjuhën maqedone librin me poezi të zgjedhura "Dvorski son". Në vitin 2000, në bashkautorësi botoi librin me dëshmi të masakrave në Kosovë "...edhe ne dëshmojmë / We Witness", Sh.b. "Ditët e Naimit" (shqip-anglisht). Shtëpia botuese italiane "La stanca del poeta – 57" në vitin 2009, ia botoi vëllimin me poezi "Stracci di vita", ndërkaq, po atë vit i botohet në gjuhën angleze libri poetik "Life's Rags". Më 2014, I botohet në gjuhën frenge librin me poezi "Les Albanian marathon". Në Japoni, "Junpa books" ia boton poezinë me titull "Duet of Roads" (dialog poetik -Taro Aizu). Sivjet, në Taivan i botohet vëllimi poetik "Dromca jete". Cikle poetike të tij janë botuar edhe në gjuhën spanjolle, hebraike, suedeze, bullgare, arabe, rumune, ukrainase, hinduse, turke, polake, boshnjake, kroate, maqedonase etj. Poezia e tij është përfshirë në disa antologji ndërkombëtare. Ka

marrë pjesë në festivale poetike ndërkombëtare dhe ata vendore. Është nderuar me disa çmime letrare e kulturore.

Ka punuar gazetar në mediumet elektronike dhe të shkruara, brenda dhe jashtë vendit. Për disa vite ka punuar redaktor i Rubrikës së Kulturës në të përditshmen "Flaka".

Është themelues dhe drejtor i Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë 'Ditët e Naimit

UDHË PA KRYE

po s'u kape për rrënjë jete
valët e hazdisura të marrin para
oxhakun tënd në nevojtore
e kthen Korbi i Alan Posë
pëllumbat as përreth s'fluturojnë

kahja e gishtit tregues
kah ti
është më e keqe se arma
ajo të shteron zërin si në ëndërr
e mbytesh djerse
në kërkim shtegdaljeje
damka në ballë
është e neveritshme
si buzëqeshja e pushtuesit
mbase për një mulli uji shkon

udhët pa krye
gjithmonë shfrytëzohen
nga kryet pa udhë

PA TITULL

nga bëmat e djeshme
tuat
unë kam të ftohtë

ti a ke?!

KOHË TJETËR

njëqind zëra
t'i kesh ndërruar
kush s'ta var më
o gjel i mëngjeseve të zbrazëta

nuk zgjohet njeri
jo

dolën
orët me zile

DEMANTUESIT KANË VDEKUR

të gjithë ata
që s'kanë qenë në Kala të Krujës
pështërisin "Shqipëria një kafshatë"

kanë të drejtë
kundërshtarët e Motit të Madh
kaherë kanë vdekur

Krujë, 1 janar 1991





BARDH FRANGU
(KOSOVË)

Bardh Frangu (1956), ka mbaruar studimet për Letërsi dhe Gjuhë Shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës. Jeton në Ferizaj. Aktualisht punon si redaktor i kulturës në të përditshmen "Zëri" të Prishtinës. Merret me publicistikë, kritikë letrare dhe teatrore. Ka botuar këto libra: "Ora e shtëpisë", poezi, "Rilindja", Prishtinë 1989, "Kohë të kauçukta", roman, "Rilindja", Prishtinë 1993, "Fluturimi dhe rënia e Ben Balës", "Rozafa", Prishtinë 2004, "Laviret e duan atdheun më shumë", "OM", Prishtinë 2014 dhe dramat "Udhëtim në përjetësi", "Sheshi i krenarisë" dhe "Duke pritur trenat", Klubi Letrar "De Rada", Ferizaj, 2015.

NËN QERPIK TË THYER

Nën qerpikun tënd të thyer nga mërzia
Qëndroj si zog i lagur nën therë
Të shpëtoj nga dimër i acartë
Nga erërat e harlisura dëshpërimi
Që i bartë mbi shpinë një fjalë halë
E sonte është natë e madhe
Mëngjesi do t'ju mbes gjelave në fyt
S'do ta vjellin as s'do ta përpijnë
Portë e ditës do të mbetet mbyllur
Më le të qëndroj nën syrin tënd të kaftë
Ndërsa nuk u takuam në dashuri
Së paku në dhembje të jemi bashkë

SHUMË MË KA MARRË MALLI

Atëherë shtëpitë nuk ishin të bukura
Po dyert e tyre hapeshin me zemër
Dhomat mbusheshin buzagaz
Fjalët pëlcitnin bashkë me gështenjat
Atëherë libri ishte direku i shtëpisë
E gjithë çatia peshonte mbi të
Dhe kur gjuanin rrufetë
Strehoheshim brenda kopertinave
Atëherë nuk e dinim sa ishte ora
Nuk është folur për viagra e kondomë
Dita ishte e mbushur me punë dhe halle
Nata kishte një shtrat plot gjumë
Sa më ka marrë malli të fle
Nga perëndimi i diellit deri në lindje
Malli më ka marrë ta shoh ditën
Si mbillet nëpër ara me grurë

PËR ASHTIN E SYRIT TËND MARË

Ti ishe krejt seks Marë
Ndaj sytë t'i mbushën spermë
Gjinjtë t'i prenë me thikë
T'i varën në degë molle
T'i përdorin pastaj për meze
Të dehen me shlivovicë

Sa mirë që nuk t'i bluan eshtrat
Sa mirë që t'i fshehën në tokë
Tash unë ec dhembshëm mbi ta
Si qeni pas pronarit të vet

Në listat e të pagjeturve
Çdo ditë të shikoj të uroj
Të shpërthesh një ditë tek trëndafilat
Të shohësh si po thahem në trotuar
Për ashtin e syrit tënd Marë

ARJAN KALLÇO
(SHQIPËRI)

Arjan Kallço lindi në Korçë më 22 nëntor 1967. Frekuentoi shkollën e mesme Raqi Qirinxhi në qytetin e lindjes dhe më pas Universitetin e Tiranës, në degën Gjuhë Italiane, ku u diplomua në vitin 1990. Ka dhënë mësim në shumë shkolla të qytetit të Korçës dhe si pedagog në Universitetin Fan S. Noli.
Ka qenë disa herë bursist i Ministrisë së Jashtme Italiane në Peruxha, ku ka kryer edhe studime për tema gjuhësore dhe letrare.
Që nga viti 2008 është pjesëmarrës në Konferenca të shumta Ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit, si në Korçë, Selanik, Tiranë, Kraiovë, Banja Luka, Shkup, Sofie, Tetovë, Ljubjanë, Ohër, Stamboll etj.
Është Ambasador i Akademisë UNIVERSUM, Zvicër për Shqipërinë
Është anëtar i Shoqatës Ndërkombëtare të Kritikëve Letrarë me qendër në Itali dhe ka marrë pjesë në disa konferenca të saj si, në Morra de Sanctis dhe Leçe.
Është zv/sekretar i Lidhjes së artistëve Pegasi- Shqipëri
Është sekretar i Klubit të Shkrimtarëve "Bota e re", Korçë

Ka përkthyer :
-Proverba të gjuhës italiane,
-Poezi italiane për dashurinë,
-Tregime të shkrimtarëve italianë të viteve '80,
-Novela Plaku i mirë dhje vashëza e bukur,
-Lundrim nëpër valë – (antologjia e poetëve bashkëkohorë italianë)
-poezi dhe tregime të shumë autorëve italianë dhe të

tjerë të botuara
nëpër revista, gazeta dhe internet.

Është autor i disa vëllimeve me poezi :
-Pafundësia jote më deh-poezi të shkruara gjatë qëndrimit në Greqi;
(versione dygjuhëshe të librit të tij të parë me poezi: shqip-greqisht, italisht-greqisht etj.)
-Imazhe të jetuara jete – poezi të shkruara në Itali,
-Flatërim nëpër stinë – poezi udhëtimi nëpër Evropë;
-Volum me Haiku : Rreze aureolash

Është autor i dy vëllimeve me tregime :
-Ëndrrat thyhen shpejt,
-Shkëndija drite mes reve.

Në vitin 2016 boton dy volume me haiku në shqip dhe italisht
-Vallëzimi i gjetheve (italisht)
-Vargjet kanë mall
-Ribotimi i volumit Flatërim nëpër stinë
-Urtësia s'është kurrë e tepërt

Merr pjesë në shumë konkurse në shumë vende, si në Itali, Shqipëri, Kosovë, Greqi, Amerikë
dhe poezitë e tij botohen në antologjitë respektive.
Vitet e fundit boton me gjigantin e editorisë Amazon.

Është fitues i çmimeve :
-Në festivalin Netët korçare të poezisë çmimin e Përkthimit
-Në janar të vitit 2014 u laureua në Romë në Selinë italiane të Parlamentit Europian :
"Një poet për Evropën"
-Në Festivalin e Strugës, korrik 2014
-Në Ulqin çmimi i I nëntor 2014
-Në Ulqin çmimi i II nëntor 2015
-Në Itali video-poezi, çmimi i III 2015
-Në Ulqin çmimi i III shtator 2016
-Në Salamina, Greqi laureat i Medaljes së artë "Aleksandri i madh"

KUJTIMET QË NUK NGRIJNË

Më the se një ditë do më shkruaje
irinë e bukur ruse, që kujtimet të merrnin
menjëherë fluturim.
Peruxha jonë e dashur është jetime
pa ne, dhe endet mes agimesh shprese
tek pret kthimin tonë, si dallëndyshet
që përkohësisht nuk ndodhen atje.
Fati i kohës nuk mund të mashtrohet
më.
Disa javë s'mjaftojnë të hapësh
zemrën dhe t'i dhurosh pak liri,
do të mjaftonte vetëm një çast
magjie për ta lumturuar
për t'i dhuruar erëra të vrullta
e plot nostalgji.
Në mendje i kisha të gjithë
poetët e vendit tënd,
poetët e vendit tim,
edhe vargjet që
ende digjen nga dashuria,
tek mbetën të shkruara
rrugëve të çmendura të Moskës e
Petërburgut, në çdo puthje, në çdo takim.
Dhe unë prita, e prita një fjalë,
një puthje nga larg që tashmë
rëndë-rëndë ishte nisur për shtegtim.
Pritja po dremit këtë dimër
të ftohtë janari ku vetëm kujtimi
s'po ngrin.

Bashkërrugësi hapash
Hapat e tu qetësisht të ndrojtur,
Të kapur peng nga një pafundësi mendimesh,
Pa e ditur dhe pa e kuptuar, shtrihen
Në një rrugë të vetme, bashkë
Me kujtimet e mia të rinisë. Vite të
Mbetur diku larg, në disa akriva bardh' e zi
Të qytetit, por që në fakt i tillë
Nuk ishte. Të tjera dashuri, ndoshta sot,
Do t'i kishim hedhur prapa, braktisur
Në godinat e shembura të jetës,
Ma brengosnin shpirtin. Një dallgësi
E papërmbajtur moshe që, duam s'duam,
Ronitet pak e nga pak, si uji i detit
Kur bregun prek fillikat i vetëm, pa
Pasur më nevojë për konvencione
Të firmosura mbi letër.
Eh, ti, vashë, e kam më se të qartë,
Nuk je veç vegimi që shpejt

Do të shuhet, andaj mos u bëj xheloze
Për një kohë që s'është kurrë e jotja,
Tash e copëtuar në detaje shpërfillëse
Dhe të zbehta. E tashmja ka
Ngjyra marramendëse, fluturuese, funde
Edhe më të shpejtë, sepse gjithmonë
Dashuritë digjen në etapat
E domosdoshme të njohjes.

HISTORIA QË ENDE JETON

Ditëve, netëve eca rrugëve
Dhe rrugicave të historisë tënde
Me shumë histori të tjera që si hije
Të vrara nga koha e largët
Më ndiqnin nga pas. Nuk duan
Të shkulen dhe të flaken tutje
Si gjëra të pavlera, apo rrënoja
Të hedhura nëpër periferitë e reja
Pa lavdi e kokëposhtë.
Tek ty,
Çdo ngjarje vendimtare e jetës,
Edhe pse të pajetuara për ne,
Fshiheshin çuditshëm në një gurgullimë
Rrëqethëse të jehonave,
Në çdo kornizë, figurë e dekor,
Në çdo shtëpi me fytyra të ndryshme
Tek pozojnë dhe i bëjnë karshillëk të sotmes.
Shpirti - yll që s'donte të rrëzohej
Mbrujtej me baltë dhe gur dhe
I pavdekshëm formësohej madhërishëm
Imazh pas imazhi mes ambiciesh të çmendura
Të pasurisë.
Imazhe njerëzish heretikë apo hyjnish,
Sipas Erës që frynte, lindnin.
Xhelate e pamëshirshme në fron
Tundte kamxhikun ndaj paudhësive.

DINOS KUBATIS
(GREQI)

Dinos Kubatis lindi në Athinë, kreu studimet për Teatër dhe Gjuhën frenge.
Që në moshë të vogël iu përkushtua fushës së Letrave dhe Artit. Si aktor dhe regjizor punoi ne Greqi dhe jashtështetit, ku fitoi çmimin ndërkombetar ''JONESKO'', për tërësinë e punës së tij regjizoriale. Shkroi në të gjitha gjinitë e letërsisë dhe ka botuar 19 libra. Përveç, Greqisë librat e tij jane botuar në Francë, në Kanada, në Poloni dhe në Shqipëri. Njëkohesisht, Dinos Kubatis ka punuar me pasion në gazetari, me radio dhe televizion. Veprat e tij janë përkthyer dhe janë paraqitur në shumë gjuhe dhe jane luajtur shume drama te tij ne teater, ne televizon dhe ne radio. Ne vitin 2007, i jepet titulli ''Doktor Nderi i Letërsisë të Bizantit'' në Universitetin e Valencias dhe ''Akademik Nderi'' në Akademinë e Portugalisë. Merr pjesë ne kongrese te ndryshme nderkombetare te artit dhe kultures. Dinos Kubatis eshte antar i shume organizatave nderkombetare si; Shtepia e Europës, Shoqata e Kulturës Greke, Shoqata Kulturore e Shkrimtareve Te Teatron , te UNESKO etj..... E kane nderuar me cmime nga Agjencia Nderkombetare Kulturore ''Johanesburg'', i Shoqatës Nderkombetare AQEPA te Australiasë, nga Shoqata Kulturore ''Promithevs'', në Uashington, me Medaljen e Arte te Akademise Franceze te Letrave, te Delfinikes Afiktonies, te UNESKO-os ,Dafnia e Arte nga Bashkimi I 52 Akadeimikon ne Bote nen kryesine e princit Joanu - Arkadhiu - Laskari Komninu, etj. Romanet e tij historike , si ''E dashura ime Ajvali'' dhe romani i fundit qe u botua tani afer ''Në flkatë e Izmirit'' jane bere best - seler dhe

përbëjnë objekt disertacioni në Departamentin e Studimeve Moderne greke, në Universitetet e huaja... Veprat e tij jane perkthyer në: frengjisht, anglisht, gjermanish, indisht, polonisht, shqip, serbisht, turqisht, rusisht dhe në ukranisht. Disa libra te tij jane botuar në; Francë, Kanada, Poloni dhe në Shqiperi. Dinos Kubatis eshte krijues i shumë organizatave si; ''Teatri Eksperimental'', ''Organizata e Teatrit te Jonit'', Qendra e Teatrit e Ekesperimtal'', Festavali i Teatrit te Monologut dhe Qendra kulturore ''Kafeja e Ideve'' , që ka një njohje ndërkombëtare, për organizimin e përvitshëm të simpoziumit të poezisë , letërsisë dhe dhënien e Medaljes së Artë te ''Aleksandrit te Madh'' dhe '' Virgjinës'', për njerëzit intelektual, të artit, të shkencës, të biznesit, të politikës, të sportit, nga e gjithe bota.

MESAZH GREK

Bie shi, vetëtin, gjëmon dhe është verë.
Ndërsa unë i lagur gjer në kockë dëgjoj zërin tënd,
që shpaloset nga një zarf dhe jehon Greqia e tërë.
Që shpaloset nga një zarf dhe mbi pëllëmbën time ai lë
një grusht pluhuri nga mermeri i Olimpias
dhe një, - akoma të freskët, - fletë dafine nga Epidhavro,
që këputët për mua Ti dhe ''Antigoni''.
Kaluan tridhjetë e shtatë ditë dhe prej atëherë që kisha veshur Greqinë,
tridhjetë e shtatë ditë nga çasti që fluturova larg saj.
Dhe nga''good bay'' yt, i Vangjelit dhe nënës sime.
Dhe tani tej reve, e panjohura dhe vendet e reja.
Ato që nuk njoha larg jush ! Kaq shumë,
në kaq pak ditë !
Kalova vende të ngrira, vende të nxehta,
udhëtova vazhdimisht midis paraleleve 24
dhe 46 gradë,
njoha Njerëz dhe njerëz, njoha dhimbje, njoha miq dhe armiq,
qava dhe u indinjova, u gëzova dhe ndjeva keqardhje,
mora bagazhet e mia një formë nga Kanadaja,
të një zogu me shpirt të pafajshëm, nga Ontario
dhe i shëtita në shkretëtirën e shpirtit tim.
Shkrova poezi, të shkrova letra...
Ndërsa sonte erdhi sërish aroma e pishës së egër,
-brenda në letrën tënde, aroma e tokës sime.

Mbi këtë tokë të dashurova,
mbi këtë tokë dashuroj ato që dashurova
dhe mësova aty sipër çdo të thotë dashuri.
Dhe erdhi era nga hojet dhe mjalti i egër,
erdhi përsëri shpresa e qiellit blu.
Në një letër tënden, një atdhe i tërë,
në një varg timin adhurimi im për të.
Tek ai jetojnë të vdekurit e mi,
tek ai të gjallët e mi do të vdesin.
Dhe erdhën vargjet e tua me shijen e ullirit grek,
erdhën skicat e tua të vizatuara prej pikëllimit
dhe vetmisë.

Luftoj me shkopinj me vetëtimat, rrufetë.
Përreth meje, eroma e tokës së lagur.
Por unë marr erë nga pjalmi i tokës greke,
që ma dërgove brenda në zarf !...

Washington D.C., 1982.

DRINI I SHQETËSUAR

Drini herë- herë qetësohet disi
dhe herë të tremb me vrullin e tij.
Bukurinë e tij truri yt nuk mund ta nxë
dhe nga zemra jote koha nuk e nxjerr.

Pasi në mëngjes mjegull agon ëmbëlsisht
dhe dielli i shpërndan rrezet qetësisht
më të shndritshmen prej tyre e lëshon,
në ujërat e Drinit e rrezaton.

Drini i zbret poshtë ujërat e tij,
me diell, me breshër ose me shi,
nuk qetohet asnjë minutë, asnjë çast,
Drini me shpirtin tim sa shumë që ngjan !...

Drini i Bardhë, 2015.

SARANDË

E skicuar në krah të Detit, bregu
në duart e tij nanurit dallgët e qeta,
duke udhëtuar në horizonte dhe në pafundësinë e botës.

Dallgët magjistare të historisë së botës,
si brenda një guaske kujtimesh, kumtojnë
në bregdetin miqësor legjendat që dëgjuan
nga sirenat dhe përbindëshat mitikë të detit.

Dëgjon bregdeti Sirenat që rreth tij këndojnë
këngë të pashqiptuara mirë që tinguj të rinj
nxjerr nga guaska lëvozhgë e alabastrit.

Aty, në gjurmët e Horezmit të lashtë,
netët magjike ëndërrojnë dhe
të dashuruarit mbrëmjeve shpërndajnë argjend
me pluhurin e yjeve.

Me një kitarë me tre tela, formojnë nota
zotat dhe vajzat hedhin valle,
mbi harqe violinash.

Finiqi, Butrinti,
lavditë e tyre lartohen dhe i bëjnë hije
diellit dhe përkujdesin vendin,
që prekin me dashuri dy detet.

Piratët kusarë ndriçojnë ngadalë larg
vendin e lumturisë, të ndjekur prej
burrave mbrojtës të Lirisë,
luftën e kotë mes njerëzve.

Filizin e ullirit e sjell pëllumbi i bardhë
në sqepin e tij dhe ia shenjtëron gjethet
në ujërat e detit blu.

Miq, armiq, pushtues, fantazma,
ngrihen në yjëzimin e natës,
për të kërkuar ''falje'' prej
qytetit shekullor që ata tradhtuan.

Grekë, Bizantinë, Romakë, vallëzojnë përsëri
në rrënojat e kështjellave të pushtuara, rrokullisen
të dehur nga bukuria e vendit.

Mbretër, Mbretëresha, Princër, Shenjtë,
pushtues dhe çlirimtarë,
ngrenë një panair të përbashkët dhe bekojnë
që jetuan në krahët e tij.

Sot, mjegullën e Historisë, si në ekran
shpërfaqin lavditë, duke mbajtur në duar
kurora dafine.

Sot, bukuria shkëlqimtare
mbulon njerëzit dhe Historia
e quan fëmijën e saj të zotë
dhe krenohet me të drejtësisht.

Sot, Zota luftëtarë dhe heronj,
me përulje shfaqin dashurinë e tyre
për qytetin modest, të denjë, përkulen
dhe bien në gjunjë.

Sarandë, 2014.

Përktheu nga origjinali: ILIAZ BOBAJ



KOPI KYÇYKU
(SHQIPËRI)

Kopi Kyçyku është doktor i shkencave, inxhinier, akademik, shkrimtar, historian, përkthyes, gazetar, eseist, profesor universiteti, lindur në Pogradec më 1943, ka kryer studimet në Fakultetin e Gjeologjisë e të Minierave dhe Histori-Filologji (degët gjuhë-letërsi dhe histori), është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë qysh më 1967, autor vëllimesh me poezi, tregimesh, dramash, pamfletesh e fejtonesh, artikujsh kritikë dhe studimesh shkencore; përkthyes i shumë veprave letrare, historike dhe gjeologjike nga disa gjuhë në shqip, si dhe nga shqipja në rumanisht, italisht e turqisht. Veçojmë këtu shqipërimin e Antologjisë së Poezisë Rumune me rreth dyqind autorë. Është Laureat i Medaljes së Artë "Mihai Eminesku", akorduar me Dekret të Presidentit të Republikës së Moldavisë (2012), anëtar themelues i Fondacionit Evropian "Nikolae Titulesku", anëtar themelues dhe anëtar i Komitetit Drejtues Ndërkombëtar të Qendrës Evropiane të Studimeve Ndëretnike dhe të Komunikimit pranë Akademisë Rumune, anëtar themelues i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Evropës Qendrore, anëtar titullar i Akademisë Evropiane të Arteve (Belgjikë), anëtar i Këshillit të Nderit të European Academy of Performing Arts, Doctor Honoris Causa i Universitetit "Danubius" të Galacit (Rumani), Kavalier i Shën Sivestrit Papë, anëtar i kryesisë së Shoqatës së Ballkanistikës dhe Sllavistikës, anëtar nderi në shumë akademi dhe forume shkencore ndërkombëtare, president themelues i Fondacionit "Simpatizuesit e Ataturkut" dhe i Shoqërisë Kulturore Shqiptare "Haemus", themelues dhe bashkëdrejtues i revistës evropiane dygjuhëshe (në shqip e në rumanisht) me të njëjtin emër, që botohet në Bukuresht qysh më 1998, themelues dhe botues i revistës „The Eastern European Messenger", që del në Londër në gjuhën angleze etj.

Në periudhën 1966-1993 ka pasur funksione të ndryshme: zëvendëskryetar i Komitetit Ekzekutiv të K. P. të Rrethit të Pogradecit, deputet e anëtar i Komisionit të Jashtëm të Kuvendit Popullor, drejtues sektorësh në Radiotelevizionin Shqiptar, në Ministrinë e Punëve të Kashtme dhe në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.
Ka marrë pjesë me referate dhe kumtesa në mjaft kongrese dhe simpoziume shkencore, të organizuara në vende të ndryshme të botës e ka dhënë mësim, si profesor i ftuar, në universitete të Evropës, Azisë dhe Afrikës, duke u nderuar me çmime për veprimtarinë shkencore-didaktike dhe për përkthime. Është zgjedhur nënpresident i të pesëmbëdhjetë edicioneve të Kongresit Ndërkombëtar të Botës Shpirtërore Rumune.
Në fushën e historisë ka shkruar dhe ka botuar në shqip, rumanisht e italisht një numër të madh monografish, ndër të cilat: „Mustafa Qemal Ataturku", „Turqia e Pasluftës së Dytë Botërore (1945-1985)", „Kryengritja e armatosur e Ilindenit, Maqedoni (1903)", „Marrëdhëniet shqiptaro-rumune gjatë shekujve", „Arumunët e Shqipërisë në kontekst ballkanik", "Arumunët në optikën shqiptaro-rumune", "Historia e Shqipërisë", „Pater - Emil Konduraqi", „Historia e Maqedonisë", „Ataturkizmi dhe Turqia e Mijëvjetshit të Tretë", „Histori e shkurtër e Azerbaixhanit", „Algjeria – e shkuara dhe e tashmja", "Zinxhiri i anktheve – radiografi e çiltër për vete dhe për të tjerë", "Hajdar Alijevi – një Ataturk i epokës sonë", "Me pushkë e penë – Hristo Botev", "Historia e teatrit botëror (në tre vëllime), "Mes shtigjesh e trandjesh", "Dy Evropa – një divorc intelektual" (me bashkautor akademikun Razvan Theodoresku), "Rruga drejt përkryerjes" (me bashkautor Horia Netoresku-Balçesht), "Një evropian i madh" (me bashkautore prof. Zoe Petre) etj. Është autor i tekstit universitar "Stilistika e gjuhës italiane".

MOS NDOSHTA...

A ndoshta ngaqë smira, si bisha s'më është ndarë
dhe shpesh më ka plaguar, por dot nuk më ka vrarë;
a ndoshta ngaqë nëna m'u tret qysh në të ri,
dhe motra pas e ndoqi, në ankth e tragjedi;
pa dashkam të më falin një çikë mall më shumë,
paçka se zemra e shkretë dhe bën,
por dhe s'bën gjumë.
A ndoshta se lakmia në shpirt më paska hyrë
e rrudhat çnuk po bën t'm'i fshijë në fytyrë,
pa dashkam tej së drejtës, me afsh, por dhe me duf,
një yll nga më të rrallët? I gjori plak matuf!
Mbi supe

Mbi supe mbart një zog, që flatrat rreh,
Nga fjalët më jan' bërë buzët gjak,
Si vdekja, dashuria kosën mpreh
Mbi ndjenjat që i vret, ose merr hak.

VDEKJE E PËRKRYER...

Edhe në qofsh prej guri, granit apo beton,
Kalon koha ngadalë, shkujdesur, me durim,
Me dhëmbët aq të mprehtë sikur të ledhaton,
Gjersa të shndërron në rërë prej plazhi plot shkëlqim.
Të vraka edhe drita, të vraka edhe terri,
Të vraka helmi, gazi, trishtimi dhe mërzia,
Të vraka thjesht vështrimi, dhe puthja erë ferri,
Por vdekja e përkryer vjen veç nga dashuria.

PRIT!

(Duke marrë shkas nga leximi i Lutjeve
dhe i Librave të Shënjtë)

Të kam thirrur me dëshpërim, o Zot, me drithëma,
duke vajtuar,
Kam dëgjuar zërin Tënd të ëmbël që gjithkënd
magjeps, mahnit,
T'u luta të më japësh dritë, udhën e drejtë për të
më treguar,
Me mirësinë e pamatë më the veç kaq:
"O biri im i dashur, PRIT!"

Më mësove të vij tek Ti, të kërkoja dhe do më jepje,
vetëm të besoja,
Premtove se do të më ndihmosh kudo që të jem,
edhe në infinit,
Por ndjehesha i humbur dhe të thërrisja prapë,
papushim vajtoja,
Ti më përgjigjeshe butë me durim:
"O biri im i dashur: PRIT!"

Isha i zhgënjyer, e padrejtë dhe e tmerrshme më dukej
jeta mbi dhé, Shikoja nga qielli me pafuqi e përsërisja:
"Çfarë të pres më?"
Atëherë zbrite tek unë, më vështrove në sy e më the:
"Deshe një shenjë? Kaq kishe dashur ti? Një zë?"

Shtove: "Mund t'i lëviz malet edhe ta fik pa
ngurruar diellin,

T'i ringjall krejt të vdekurit dhe ta përflak
në çast qiellin,
Por po të të tregoja se çfarë të zgjidhje që të
ndjeheshe mirë,
Do të kishe përgjigje për të gjitha, por të më takoje
s'do kishe më dëshirë.

Nuk do të mundje të ndjeje dashurinë me të cilën
shenjtorët i qarkoj,
Nuk mund të merrje fuqinë të cilën të pashpresëve
ua dhuroj,
Nuk do të prisje i heshtur një rreze që largon retë e
dëshpërimit,
Nuk do të shijoje qetësinë e shenjtë që vjen
pas mundimit!

Nuk do të dije të ecje me besim tek unë, nuk do shihje
që pranë teje rri, Zemra jote e turbulluar nuk do të
kërkonte të gjente tek unë qetësi!
Nuk do ta njihje plotësisht as për nga larg dashurinë
time qiellore,
Që ta mbush jetën me paqe e me plot dhunti hyjnore.

Po qe se dhembja jote do të zgjaste vetëm një çast, ti
nuk do të luftoje! Nuk do të dije ç'është ngadhënjimi,
as ç'mund të kesh falë vetëflijimit tim, s'do ta kuptoje!
Mund të përmbusheshin ëndrrat e tua, por malli yt për
mua do të davaritej,
Nuk mund të të bëja ty një perlë të thesarit tim,
gjithçka do të venitej!

Pra, o biri im, çapitu mes stuhive dhe mendo ditët e
lumtura, siç thua, Duke ditur që dhurata më e madhe
është takimi me mua!
Edhe në mos gjetsh përgjigje dhe jeta të duket
e padrejtë, të mërzit,
Mos harro që jam me ty atëherë kur me durim të
them: „PRIT!"

18 Gusht 2016

NË SQEP I MBIU...

(Në frymë popullore)

Kur u kthye me ushqim për të vegjlit zogu - at, i ziu,
Folenë e **gjeti** bosh, pa zogj, të shkretë, pa jetë,
Kërkoi por nuk i gjeti, iu thinjën pendët krejt,
Dhe fara, më në fund, në sqep atij i mbiu.



NIVEDITA LAKHERA
(INDIA)

U lind dhe u rrit në Nju Delhi (Indi) në një familje shumë të ngrohtë dhe mbështetëse. Në moshën 27 vjeçare, jeta e saj u trondit dhe u nxor nga binarët nga një apopleksi masive e pasuar nga një divorc, dhe pastaj një copëtim zemre. Për ta shpëtuar shpirtin e saj, u kthye te fjalët dhe ngjyrat. Dhe po, ato vërtet e shpëtuan. Dhe tani ajo dëshiron t'i ndajë me të gjithë. "Jastëku i ëndrrave" është libri i saj i parë me poezi. Ajo beson sinqerisht që, përtej sferave të kohës, klasës, opinionit, lindjes dhe fesë, të gjithë prej nesh jemi të lidhur me fijet e përbashkëta të dashurisë, humbjes, gëzimit, brengës, tradhëtisë, mbështetjes dhe miqësisë. Dhe kështu një poezi, një varg, një fjalë bëhet një tempull të cilin të gjithë mund ta vizitojnë dhe ku të gjithë mund të pushojnë shpirtrat e tyre para se të nisen në udhëtimin e ardhshëm - Një strehë dhe oazë përkatësie dhe afërsie... që të gjitha zemrat rrahin njëlloj! Ajo është mjeke e pasionuar për të ndihmuar njerëz me mbështetje të pamjaftueshme, që t'u mundësohet kujdesi mjekësor nëpërmjet teknologjisë. Për këtë qëllim po zhvillon një platformë telemjekësie dhe një platformë universale elektronike për dosje mjekësore (electronic medical records, EMR) për kampe me refugjatë nga Siria, katastrofa aktuale dhe zona të largëta në vende në zhvillim. Ajo po përdor këtë libër për të sensibilizuar për këtë mundim dhe për të mbledhur pare për të.

1- Mos më kthej në një hyjneshë
mos më vendos në një tempull tullash dhe llaçi
mos më lavdëro për qetësinë time...
dhe mos më shpërble kur shtyp çdo shqisën time

dhe mos quaj heshtjen time një ujë të shenjtë
Mos bej lutje për kujdesin tim
dhe mos më lidh pesha nderi në gojë, lëkurë dhe
këmbë
mos më kthej në një hyjneshë
duke më mbajtur larg tokave të përshpirtshme
kur mitra ime përgatitet për ta mbajtur gjallë njerëzim-
in
mos më ofro turp
kur plotësoj ciklin e jetës...
mos më rretho me shkrime rraskapitëse
mos qep kufi për zemrën dhe shpirtin tim
që nuk do të qepje për vetveten...
krrelat e mia i përkasin erës
zemra ime u përket ëndrrave të egra
shpirti im kapërcen rrugën
që secila prej qelizave të mia
kanë ujdisur me qiellin...
Nuk do të të ofroj
pastrimin e damarëve të tu
me gjakun e ëndrrave të mia
mos më kthej në një hyjneshë...
Dëshiroj të jem e lirë
dhe ky është shpirti i shenjtërisë sime...
refreni im nuk është larja e mëkateve të tua...

04/24/2017

2-
Ti
Nuk
Më largove
Edhe pse
Isha një tanzanit
Në mes të diamanteve të bukura
Ku njerëzit
Flisnin vetëm
Në një gjuhë
Prej drite të bardhë
Ti mbajte fjalët e mia
Në gojën tënde
Me shkëlqimin e tyre
Të kaltër
Dhe kaosi
U bë xhazi...
Isha e huaj
Kështu më ktheve
Në një faltore

Më preke
Si një lutje
Mëngjesi

Mblodhe
Ndjenjat e mia
Në pëllëmbën tënde
Si ujë të shenjtë
Gëlltite
Dallgët e mia tsunami
Dhe i mbajte në barkun tënd
Dhe i le të dhunshme jashtë meje
Kështu që mund të fle
Një herë në jetën time

Dhe i zure
Demonët e mi
Njërin pas tjetrit
Dhe u the
Pse nuk na duhen më
Pse nuk më duhen më...
Dhe ata ikëm
Me të gjitha rrënojat
E gjuhës sime të trembur, fytit të lodhur
frikave djegëse dhe këmbëve vrapues

Po atje u ndjeva përsëri
Si një vend prej
Mundësive të pafund
Me lirinë e pranverës...

Ti ishe stina
Të cilën ka pritur zemra ime
Një stinë që rritet
Mjaft për gjithë jetën

Ja pse të dua
Nivedita Lakhera

3-

Dhe kur je
rrethuar nga
më shumë arsye për të ndier
që nuk je mjaft
dhe nuk bën mjaft...
Përqafoje veten ngushtë
Preki eshtrat, dhëmbët dhe flokët e tu

Shijo frymëmarrjen e freskët në gojë
Ndiej lavdinë të jesh e gjallë
Përqafoje universin
Që të ushqen
me diell, ujë, dhe
bimë, net me yje e shumë më shumë
Ke lejen të jesh
e brishtë, e fortë, e dobët, e plagosur -
je e lavdishme
në të gjitha format e tua
kështu
Pusho
merr frymë dhe

ndaj një buzëqeshje...
Ndaj një lot
Ndaj një përqafim
Ose mos ndaj asgjë
Jo të gjitha
Ditët
Duhet të jenë të zgjuara
Dhe duhet të
Jenë të gjalla dhe të numëruara
Pak ditë
Janë
Për të vdekur
Dhe për ty djegur në
Bërjen e asgjëje

Pusho
Merr frymë
Pusho
Merr frymë...

Shëtitu
Mos vrapo

Nuk është garë
Nuk është garë

Ajo që të takon udhëton drejt teje.
Ti je qëllimi i fatit tënd...

Fitoje veten para se ta harxhosh veten

Pusho para se të ecësh

Përktheu: Silke Liria Blumbach

GERRY VAN DER LINDEN
(HOLANDË)

Gerry van der Linden, shkrimtare Holandeze, u lind në Eindhoven, më 25 Nëntor 1952. Van der Linden, ka botuar përzgjedhjen e saj të parë me poezi, " Shënime", në vitin 1978. Në vitin 1979 ajo shkoi në USA, jetoi në New York dhe San Francisko për katër vite. Pas kthimit në Holandë, botoi librin me poezi, 'Rënie nga tehu"

Van der Linden, është profesoreshë e të shkruarit kreativ në Amsterdam. Ka punuar për PEN qendrën e Holandës. Poezitë e saj janë përkthyer në shumë gjuhë të botës. Është botuar në Bullgari, Angli, Francë, Gjermani, Rumani, Indonezi, Maqedoni, Turqi, Slloveni, etj.

Është autore e shumë librave, e midis tyre : "Zarf', 'Era', 'Në duart e mia prej flatrash', "Qelq rëre ', "Rrugë pafund", 'Njerëz të mirë", etj.

Gerry e shpreh me krenari se djali i saj Luani, (Kantautor dhe autor tekstesh) njeriu më i rëndësishëm në jetën e saj është prej gjaku shqiptar. Ajo është një nga poetet më të njohura të Holandës. Romani i saj "Era" është përcaktuar nga kritika si libri më i bukur i kohës nën penën e një shkrimtareje femër.

1. I FTOHTI PREK ZJARRIN

I ftohti prek zjarrin
I nxehti ngrin
Ne biem
Gjersa të mos mbetet asnjë lutje
Ne lëndohemi deri sa të mos mbetet asnjë dhembje

Kohët ndryshojnë
E ne të njëjtë mbetëm…

2. KU PISHA GJELBERON

Koka e larvës
Rritet prej tokës, toka
Me bujarinë e saj madhështore
Si boçe e gështenje
Që mban frytin

Shtëpitë njëra - tjetrën prekin
Dhe shiu bie
Larvat dalin nëpër
Vjollca që pulitin sytë

Secili qetësinë thyen
guaskash të zbrazura fjalësh
Rrënjët zënë vend
Nëna mban tabakanë
E çajit të ngrohtë prej bimësh

E udhën nis përmes drurësh
Ku shtëpia më pret
Frika e përhershme
Se mos më kanë rrëmbyer
Fëmijët
Bijat dhe bijtë…

3. NJË GAZETË NJË KËND NJË E FSHEHTË

Nuk dua t'i lexoj gazetat
Nuk dua t'i lexoj gazetat
Nuk dua t'i lexoj gazetat

Asgjë s'mund ta përmbaj
Asgjë s'mund ta përmbaj

Asgjë s'mund ta përmbaj

Asgjë më nuk më mban
Asgjë më nuk më mban
Asgjë më nuk më mban

Një gazetë, një kënd, një e fshehtë fëmijësh…

Nis e them se ti je një dunë rëre
Në një shkretëtirë
Ose një kokrrizë rëre në kyçin e kohës

një stuhi rëre
midis poreve dhe fytyrave
një oazë e paqenë
në një natë pa hënë

Them, je një e kollitur
Në thyerje të ditës
Muzikë e panjohur popullore dhe pse jo
çdo lëvizje tjetër e panjohur

e je një dune që endet
mbrapsht
Them se asgjë nga këto
Nuk është ajo që jam
era që s'ndal

4. NUMURIM

Është një orë që se njoh
Pjesësh të pamatshme
Që ecën vetë

Është një natë që se njoh
E papërshtatshme lëkurës
Në thellësi të zemrës mënjanuar

Është një pështërimë që se kuptoj

E flaka tej dhe eci me bukën e mëngjesit
Si stafetë

Është një orë që se njoh
Njerëzish, kafshësh, mjetesh.

5. LUANIT

Të hedhësh gurë mbi dallgë
Rrotull teje, ende
Dëshiruar të them
Pa përgjigje,
mos bëj asgjë.

Tani kumti i fjalëve kthehet
Mbi të njëjtët gurrë, të njëjtin shkëmb
Dhe shpresoj, shpresoj e dridhem
Nën rroba feksur në prag të derës
të arsyes në luftë të heshtur
I njëjti gur
I njëjti shkëmb
Godet drejt, lëshohet jashtë
Si breshër

puthjeve që më hëngrën shpirtin
po të them thjesht
pa krenari
kam derdhur në një rreth uji
Një oqeani të zbrazët

Përktheu: Entela KASI



MARTA MARKOVSKA
(MAQEDONI)

Marta Markoska u lind më 29.06.1981 në Shkup, Maqedoni.
Ajo është pjestare e Asociacionit të Shkrimtarëve në Maqedoni.
Deri tani ajo ka botuar 9 publikime:
"Black Holes Within Us, 2nd Edition, Macedonian-English translation ("Todor Chalovski" Award, 2015)",
"Black Holes Within Us, 1st Edition, Poetry Book ("Beli Mugri" Award, 2014)",
"Culture and Memory (Book of Cultural Studies), 2014",
"A Discussion on Zen Buddhism: A Religious and Philosophical Transcendence Between Eastern and Western Thought, a Scientific Study (2013)",
"Headfirst Toward the Heights, Poetry (2nd Edition)",
"Headfirst Toward the Heights, Poetry (1st Edition, Winner of the "Aco Karamanov" Award)",
"Hyper Hypotheses, a Collection of Essays (2011)",
"Whirlpool in Bethlehem, a Collection of Stories (2010)",
"All Tributaries Flow Into My Basin, Poetry (2009)".

TË GJITHA DASHURITË JANË SI KËPUCËT

Të gjitha dashuritë janë si këpucët
Ato që i rruajmë me kujdes
duke i mbathur vetëm në raste festive
mbeten të papërdorura, të ngushtuara, të zvogëluara,
nuk kemi lejuar t'u zhduket bukuria e tyre
por janë të përdorshme
dhe qortohemi shpesh
se nuk jemi të kënaqur me mbathjen e tyre

Ato që me gëzim të madh i mbathim
duke u kënaqur përherë,
më shpejtë i vjetrojmë, i grisim, i harxhojmë
i stërpërdorim dhe më në fund i hedhim
dhe me keqardhje mendojmë
pse nuk blemë dy palë nga ato të njëjtat
që t'i përdornim më gjatë
që t'i kemi si rezervë
që të na gëzojë ideja
se mund t'i vishnim sa herë që duam

Në realitet më gjatë qëndrojnë
ato që më pak i pëlqejmë
apo që i shtyjmë anësh
i humbim diku në brendinë e ormanit
dhe i harrojmë me javë,muaj, vite
që pas shumë kohësh të kuptojmë
se ato përherë kanë qenë aty pranë
edhe pse ne i kemi harruar, hedhur
dhe asnjëherë me dashuri nuk i kemi mbathur.

ENTROPIA E DASHURISË

Dikur bëja rrëmujë në sistemin tënd
jo për të ta dëshmuar praninë
Entropisë së formuar përherë
kur dy trupat tanë qenë në marrëdhënie njëri me tjetrin
pasi asgjë të re nuk të tregova
Termodinamika qysh herrët është shpik
dhe shumë gjatë do na përkujtoj
në harxhimin e energjisë
së marrëdhënies sonë të ndërsjellë.

Dikur prodhoja kaos në vendin tënd
jo për të të rrënuar sistemin tënd të vlerës
por sa për të ngushëlluar
në ato rregullat e lojës që sundojnë edhe në kozmos
kurse ne jemi dy gropa

që janë bashkuar dhe kanë thithur
njëra nga tjetra tërë atë energji
më shumë se sa që ka qenë e ndërtuar në sistem
dhe tani zbrazët, shpresojmë që përsëri do të shndërr-
ohen në yje

Tani të siguroj se dy lidhje,
dy trupa, dy shpirtra
prodhojnë shumë e më shumë entropi
se sa secili trup në vete.

ASTRONOMIA E ZBATUAR

Derisa më thua
asgjë nuk është ndërruar
Kozmosi është zgjeruar
kurse ne jemi disa galaksi
larg njëri tjetrit!
Derisa më thua
se në shpirtin tënd është vrarët
kurse aura ime e mbushur me diell
të përkujtoj se teoria e kaosit
është krijuar nga metodologjia

Derisa më thua
se duhej ta ndalnim kohën
kur dashuria ishte në vrullin më të madh
dhe trupat me fuqi më të fortë magnetike
të përkujtoj se vrimat e zeza
u krijuan nga implozimi vetjak
dhe tani ato ekzistojnë edhe te ne!



NAIDA MUJKIÇ
(BOSNJË DHE HERCEGOVINË)

U lind më 1984. Është poetet boshnjake. Ajo është e apasionuar me gjuhën, dhe kornizat poetike të poezisë së saj, siç thonë kritikët, nuk mund të përshkruhet vetëm në një fjali. Ajo fitoi çmimin e parë në Festivalin letrar Slovo Gorçina – çmimi më i rëndësishëm për poetët e rinjë në koleksionin e poezive të papublikuara në shtetin e vet (2006). Ajo posedon diplomën per master, 'Teoria dhe praktika e studimeve të literaturës Postmoderne', dhe për shumë vite ajo jep mësim në fakultetin e Filozofise për Literaturë. Ajo gjithashtu shkruan për revistën STAV. Ajo është pjestare e qendrës PEN, BiH dhe Lidhja e Poetëve Global nga Korea Jugut. Për dy muaj ajo ishte Artiste në Rezidencë në Muzeun e Vienës (Austri, 2016).

Librat me poezi:

Fluctuations/ Oscilacije, Zoro, Sarajevo-Zagreb, 2008.

Love bonds of moguls/ Ljubavni šarti mogula, Buybook, Sarajevo-Zagreb, 2015.

Saffron/ Šafran, Centar za kulturu i obrazovanje, Tešanj, 2016.

Librat e saj janë shfaqur në shumë vende të botës, si dhe në disa revista me më ndikim (siç është: Lichtungen, International Times, Poezija, Izraz, Razlika/ Differance, Republika poezije…) Libri saj i dytë është përuruar në Buch Vienë (Viena, 2015), dhe gjithashtu në Literaturhaus Graz (Graz, 2015). Poezitë e saja janë zgjedhur në Antologjitë në poezinë boshnjake, si dhe në antologjinë e gjeneratave më të reja të ballkanit të poetëve. Ajo morri pjesë në disa Festivale Ndërkombëtare të poezisë.

PURIFIKIM

Nën lakun e qenve të zinj, ata erdhën nga Ozgrodon,
Çdonjëri nga ato, ish' dëshmitar i sho-shokut,
Nën rrëmujën e mbetjeve të dështimeve të viteve
 të fundit.
I kursyer, kallajisur në pyetjen e vet të mugët – Ku je
ti?,-më pyeti
Ndërsa rrokullisej më qetësisht se hëna.
-Brenda teje- u përgjigja. Por të zinjtë budallenj nuk
më dëgjuan.
Dhe u ndjeva si një pecetë katrore, me damka në të,
mbi të.
Nëna ime jetoi një jetë, si të ishte e saja.
Askush nuk e vuri re moralin tonë të brendshëm.
Hapat tone në zbrazëti.
Fuqi për të mos thënë: Ne jemi kriminelët
Që zhysim dëshmitarët brenda vetes dhe
Për këtë jemi pashmangmërisht mirënjohës.
Zemrat tona të maskuara vdiqën mijëra herë që
atëherë
Përpara mureve të jashtme ku ndjemë frymën e vjetër.
Madje mësuam që s'duhet të shkojmë aq larg
Për të harruar akordet e apokalipsit që mbuluan
kopshtin tonë.
Mbyllëm derën hyrëse të shtëpisë. Nuk e dinim nëse
duhej të dilnim apo jo.
Rrëbeshi ende s'kishte filluar, kur unë vendosa t'ia
mbathja me të katra nga ajo.
Kalova mes margaritarit dhe lules së bardhë.
Mbroheshin nga gracka.
U mundova të mos i cek. Megjithëse, lulja e bardhë
ulëriti: Eja!
Mbylla sytë, i lemeritur. Nëna ishte akoma në kuzhinë,
I njëjti ritëm goditës çekiçi mishi.
E njëjta gjurmë, si laku i qenve, nën gishta
Donte ta pastronte trupin nga parazitët, krimbat,
kërpurdhat.
Por nuk u bërtet, as ua nxjerr lëngun
Ajo vetëm godet dhe godet.
Hapa sytë, i lemerisur.
Është larva, që po më lëpin këmbën.

HISTORI E SHKURTËR SI U RRITËN QENTË

Kur e pashë atë për herë të parë
Ajo ishte në grackë, e plagosur, e deformuar-
Dëshmitare e bishave të uritura që thithën
Njolla të bardha ndër petale
Sikur t'ish' derdhur miell
Në linjat e nervave të këmbëve të saj.
Atë ditë po frynte erë
Dhe disa gjethe të vyshkura
I hodhi në hijen e saj.
Ishin të gjithë të lumtur,
Ishte dita e Shën Valentinit.
Por je dhe aq shumë
Diku tutje ishin trëndafilat e vërtetë
Që mbanin aromë të mirë.
Babai u kollit: Shkruaj për milingonat
Që kërkojnë të gjejnë vetveten
Mes qimeve të tyre të trasha.
Edhe pse, fryma e atit është e lehtë
Ai ka tre kopshte me trëndafila
Dhe shtatë filiza gjëmbaç në ballkon
Ku iu kërrus shpina.
Konjak, biskota dhe thes me miell
Dhe ja ku vjen një burrë me fytyrë të bardhë,
Tepër të bardhë, i sapodalë nga qelia.
U afrua dhe tha
Shishe konjak, biskota dhe thes me miell
E dinim që s'do paguante
Siç dhe bëri
Kështu që ne, pa ngurrim,
I dhamë dhe vaj gjithashtu.
Të tjerët pas banakut ishin lodhur
Për këtë arsye nuk i treguam gjë.
S'do e kuptonin dot-
Të edukuar nga vetë lumturia e tyre
Që nuk vjen nga goja.
Ishin të sjellshëm ndaj nesh
Ishin të sjellshëm ndaj tyre
Por po e mbyllnin derën e magazinës
Ndërkohë që pinin kafe.
Dita do të të peshojë më pak mbi supe-
Zërat pëshpëritën në kokat tona,
Të fuqishme si vera që po vonohej të vinte
Gjithçka që menduam se na përkiste
Bota e gëlltiti.

KRYQËZIM

Doja të hyja brenda, por nëna
Më tërhoqi mëngën, që ishte një shenjë
Për tu ndalur në vend dhe qëndruar
Në ndarjen e padukshme, pranë frutave të rëna ,
Ku dikur bënim raki fiku.
Babai solli dhjetë shkopinj të drunjtë
dhe i përgjysmoi ato
me gjurin e tij. Ia shtova atij çdonjërin prej tyre.
Përveç të parit. Më pas, me duart e tij, ai i shtypi ato
Në brendësi të tokës.
Lagështia u përthith nga litarët që preva
Atë mëngjes përpara se uji për kafen të ziente.
E shtrënguam nga të gjitha anët. Nëna na tha
Të vështronim gjethet. Përfitova nga çasti,
Kur ajo dhe babai
Filluan ta tendosin dhe
Hodha dy në fustanin tim.
Tani, duhet të jem dhe më i kujdesshëm
Vura një rrip rreth belit. U përpëlitën
në qendrën time si fjalitë që
Po shkruaja

Translated by: Viola Berhani



XHUZEPE NAPOLITANO
(ITALI)

U lind në Minturno (Itali) në 12 shkurt 1949 dhe banon në Formia. Është i martuarme Irene Valonen, poete dhe aktore, kanë një vajzë, Gabrielën. I diplomuarpër Letërsi në Romë, në 1972, Xhuzepe Napolitano ka dhënëmësim për 33 vjet letërsi italiane dhe latinishtnë gjimnaze të ndryshëm.
Që nga viti 2006, drejton një kolanë librash të vegjël: "dhoma e poetit", në të cilën ka botuar, përveç se shumë libra të tij poetikëdhe me ese, edhe autorë të ndryshëm italianë të njohur dhe debutues, dhe sidomos përkthime të poetëve të Mesdheut, të panjohurmë parë në Itali (francezët D. Leuwers, G. Drano, E. Burgos, dhe N. Stamberg, spanjollët C. Vitale, A. Serna dhe G.Vega, tunizianët R. Chehaibi, shqiptarët A. Tufa dhe Sh. Emërllahu, algjerianen S. Negrouche, boshnjakët S. Hadzialic).
Në vitin 2008 ka themeluar shoqatën kulturore "dhoma e poetit", me të cilën ka organizuar prej vitesh njëfestival ndërkombëtar poezie në jug të provincës së Latinës. Në vitin 2011/2012, Festivali u mikprit nga ekspozita ndërkombëtare "Yacht Med Festival" (Gaeta) me poetë që vinin nga 10 vende të ndryshme.
Botimet kryesore në poezi:
Çaste 1970; Brenda gjurmës 1978; Maskë 1978; Nëse te e nesërmja gjen pak të djeshme 1989; Kri-jesë 1993; Poezi / jopoezi 1994; Fjalë fjale 1998; Zemër rëre 1998; Loja 1999; Ekuilibër i ndryshue-shëm (përkthyer në spanjisht nga C. Vitale) 2000; Kalime (5 libra të vegjël), 2002; Sextines de Campodimele (përkthimi nga Nicole Stamberg) 2002; Bashkë me ty u linda sërish 2003; Në bregun e kohës 2005; Fluturo lart, fjalë 2007; 10 poezi (përkthyer në gjermanisht nga R. Vecel-

lio) 2008 dhe (përkthyer në shqip nga R. Salihu) 2010; Antologji (poezi 1967-2007 nën kujdesin e S. Di Spigno) 2009; Masa jetësore (përkthyer në spanjisht nga C. Vitale) 2009; Ditët e Naimit (përkthyer në shqip nga E. Zaimi) 2009; Genius loci (18 poezi për N. Soscian), 2009; Fletorkë 2010; Pastaj... (përkthyer në arabisht nga A. Youcef) 2010; Ditët e Tunizisë 2011; Shfaqja e sigurisë (përkthyer në frëngjisht nga G. Drano) 2007 dhe (përkthyer në arabisht nga A. Youcef) 2011; Tren po tren (përkthyer në sërbisht nga D. Mraovic) 2011; Divine dignité du verb (përkthimi nga Athanase Vantchev) 2014; Pëshpëritje hënës (përkthyer në shqip nga I. Zajmi dhe Anton N. Berisha) 2014; A repentaglio 2015; Seminari di lettura 2015; Libertà di parole 2017.
Ai është Anëtar Nderi i Festivalit Ndrëkombëtar të Poezisë "Ditët e Naimit" dhe fitues i çmimit letrar "Ditët e Naimit".

PËRRALLË E SË MIRËS

Irenës

Vitet që kaluam së bashku tregojnë
– dashuria ime – sa na mashtruan
ditët e kaluara në përrallën e bukur
që ishte poezi e takimit tonë

Zotime më të vështira na lidhin tani
e fjalëve të bukura që i kishim alibi
ua heqim velin (besonim në përqafimin
e një buzëqeshje!)

Por durimi dhe besimi akoma na shtyejnë
të ndjekim qëllime të tjera
edhe më të vështira
si na dukeshin ato të fillimit

Të bëj për ty atë që mundem është një dhuratë
kotësisë sime për të besuar
se rrugëtimi i kaluar është kaq i dobishëm
sa të kem parashikuar qëllimin përfundimtar

Prandaj urimi vlen për të dy
nëse lodhjes do i rezistojmë
duke soditur të mirat që gëzojmë
të na mbajnë të na tërheqin e të na mbështesin.

JETA E POETIT

Nuk ka dritare dhoma e poetit
– nuk ka mure –
Vetëm ai jeton jetët
që i kalojnë përreth
duke i shndërruar në poezi –
pa ua vjedhur atyre që i kanë besuar

S'ka kohë mërzie poeti
– s'mund të lodhet –
s 'ka gjumë:
gëlojnë në të përvojat
dhimbjet e aventurat
rastësisht të përjetuara

Ka përherë shumë punë – në punishte
skalit përherë fjalët e tij –
i shqetësuar të ndez zjarre të tjera
duke ushqyer shkëndijat
që flaka lëshon

ka përherë shumë për të thënë – nëse gjen
çelësin që hap portën:
nëse flet qartë –
e di që pastaj fjalët e tij
ato më të bukurat,
do fluturojnë

Është jeta që s 'frikësohet e s 'pushon,
jeta e poetit:
ka vetëm frikë se një goditje e erës
i mbyll derën
e i fsheh një mashtrim

Kështu e jeton jetën poeti –
Një mozaik vështirë i sajuar
– hap pas hap për tu mos shkatërruar.

NDODH TË MENDOJ

Në kujtim të sime ëme

Njëzet vjet boshllëk e ndodh –
akoma – të mendoj "tani do ia them mamasë,
ti telefonoj" e ajo s' është më
(qe njëzetvjet s 'është më) e heshtja
e kësaj mungese zhurmon
siç zhurmonte prania e saj e rëndë
ajme sa e largët –

"Sa shumë nga ti" bart në
brendësi e dua ta ndaj
(por dhimbja vetanake është e begatë
nëse të ndihmon të ngritesh e
jo të biesh në lojën
e kotë të përsëritjes
– më mirë ta ruajnë kujtesë të plotë
të kësaj mungese boshe të njëzet viteve).

(Nga Italishtja në shqip Iire Zajmi)



ILJAZ OSMANI
(MAQEDONI)

U lind në Shipkovicë të Tetovës, në vitin 1954. Shkollimin fillestar dhe atë të mesmin, i kreu në vendlindje dhe në Tetovë, Akademinë Pedagogjike në Shkup, ndërsa Fakultetin Filologjik (Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare), në e Universitetit e Kosovës, në Prishtinë. Librin e parë me poezi, Lulja e fatit, ia botoi Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, në kuadrin e Shtypshkronjës "A.Z. Çajupi" (Tiranë, 1993). Recensentë të këtij vëllimi janë dy nga titanët e letërsisë shqiptare: Adriatik Kallulli dhe Abdylazis Islami. Libri i dytë i Iljaz Osmanit, që mban emrin Hapi sytë, u botua në vitin 2000, nga Klubi letar '94, i Tetovës. Është fjala për një përmbledhje me tregime, që i ka vlerësuar përmes një eseu karakteristik, dr.Luan Topçiu. Libri i tretë, me tregime, Fytyra e pasqyrës, u botua në vitin 2004. Ndërsa libri i katërt, mban titullin, Kafazi i përhitur, u botua më 2007, nga shtëpia botuese Agora Produksion. Përmbledhja me tregime me titull, Dollia e dhembjes, është libri i pestë, u botua nga Klubi letrar '94 i Tetovës. Romani, Larg nga kjo kokë, u botua në vitin 2014, nga Klubi letrar '94 i Tetovës.
Ai redakton revistën për art, kulturë dhe çështje shoqërore «Vlera».

PIRGU SHKËPUT SHPIRTËRA

A s'ť'u kalbën fijet
të të lëshojë toka
të të teprojë qielli
mos të të lëvrit floka
Ty pirg magjik
që thyen shpirtëra
që plaçkit ndjenja
që turbullon gjak
Që copton zemra
Ty pirg magjik
thembra s'ť'u plak
Pirg i pispillosur
errëtimë e fisit tim.

ERRETIMË E RRËQETHUR

Një errëtimë e rrëqethur ngjitet
nëpër qenien e qenies sime
Zigzaqet përvidhen si tekanjoze
të përveshura me piskëllimë të hollë
Kur thirri në derë
përdori thundrën e lehtë
Sa hyri në vatër
vrima e syrit të saj
Për shtatë palë qejfe
e hodhi e përhodhi hirin.

DUHMA E TUFANIT

Në plafonin heretik
me katër sy të shtjellës
stoliset skena e xhaketit të verdhë
Aktori është fodull
i duket kërthiza e sezonit
Vetes i shpall
atentat fantastik
Terrziut tufan
harlisja ia shtangu gërshërët
në agun e buzëqeshjes së tretu

MILOSAVA PAVLOVIĆ
(SERBI)

Lindi më 1958, pasi studioi Teorinë e Letërsisë në Fakultetin Filologjik në Beograd, mbrojti gradën Baçelor në Fakultetin e Mediave dhe Komunikimit në Universitetin Singidunum, Beograd. Prej dekadash është aktive në fushën e mediave.
Ka botuar dy libra me poezi, "Lojtari" (Sekcija književnika Pančevo i Pančevac, 1983), dhe "Loja" (Čigoja printing, Beograd, 2012).
Ajo është anëtare e Lidhjes Kombëtare të Shkrimtarëve të Serbisë, Shoqatës së Shkrimtarëve dhe Përkthyesve të Pančevos, Poetëve të Botës, Shoqatës së Artistëve "Arte" dhe Shoqatës së Gazetarëve të Pavarur të Serbisë.
Banon në Pančevo, Serbi.

KUR BIE SHI

Jam e qetë,
E lehtë,
Edhe pse shiu dredh flokët e mi

Nga vetja hedh
Plehrat e grumbulluar
Të ditëve të qytetëruara

Vesh
Mistere të shenjta
Dhe dal për darkë
Me Amshurinë

Që zgjedh

NJË PJATË, NJË DHOMË, NJË SHTËPI PËR XHUXHMAXHUXHË

Zvishem
Mbi paletën
Asnjë hap jashtë trupit
Asnjë hap vetvetiu

E shtyj pjatën larg

Larg vetes
As lakuriqe as e ngrohtë
Mashtrohem
Nga Dhoma e Madhe

E shtoj veten

E mbështjellur
E fsheh fytyrën
Dhe qaj
Nëpër vrimën e derës

Nuk dua të shkoj në Shtëpinë për Xhuxhmaxhuxhë

E DI

Do të të josh
Duke vallëzuar në mes të bojërave

Do t'i ofrohem penelit tënd,
Mureve të tempullit tënd.

Do të shkrepëtij para syve të tu,
Të hyj në korteksin e trurit tënd.

Do të ledhatoj çdo mendimin tënd,
Të lë shtypjet e mia vetëm brenda teje.

Do të duhet të hedhësh lëkurën
Për të më ndier, nuhatur, prekur.

You will have to love me
Aq shumë sa unë të dua.

E di.

EKREM AJRULI
(MAQEDONI)

Ç'rëndësi ka ku dhe kur u lind, me rëndësi është se ku shkeli-kaloi e çfarë gjurmësh la. Në këtë botë erdhi në një natë të ftohtë fillimshkurti, deshi të kthehet prapë në vendrritje, por nuk arriti, ngase u mbyllën portat. Gjysmë shekulli frymon në një hapësirë që vetëquhet "Oazë e Paqes", e që kutërbon parfum gomari kudo; dhe ka madhësinë e një klinike neuropsikiatrike në Kinë. Preferon jetë skifteri.
Për të ikur në LIRI ende nuk ka vendosur, nuk ka vizë është person non-grata.
Halë në sy e kanë kufomat e gjalla dhe oktapodët.

Botime:
-Marshi i Demonëve-1995; -
-Kur Qesh Doktor Valuta-2007; -
-100 vjet vargje Atdheut-2012
-20 vite me penë-2015
Rroftë e qoftë Lolestani-2004;
Palopatriotët-2012;
-Oaza e rriqrave-2014
-Strucokratët-2016

RRUGËTIM YLLI

Një rrugëtim ylli, unë kam vonesë
Vijë nga legjendat shpirtin mbush fortune
Atje ku më syrgjynose n'katakomb-harresë
Ti shpirtbardha zemërzjarrta Ajkunë

Unë jam kalorës ndaj s'më mposht gurrnia
Ti mbyllma dritaren me forcë e tërsëllimë
Me buzëqeshjen tënde do shëroj plagët e mia
Ti zapto dhe ajrin unë prapë do marr frymë

Do vijë ballëlart përmbi Vraç kalëruar
Lugjeve të Verdha nëpër ato dhiare
Do vijë këtë fillimvjeshte etjen për të shuar
Aromën ia ndjej larg mollës TETOVARE

Nëse pret të vijë në këto ditë tetori
Mos më prit në ëndërr më prit në çdo kohë
Do vijë me shpejtësi si flakë meteori
Rrugën nuk ma ndal as shtrëngatë as llohë

JAM KËTU

Nuk kam nga kthehem ooo shpirt binjak
Mes yjesh t'kërkoj sytë plot galdim
Marrëzisht më tundon i ëmbli merak
Pres shpirttrazuar nga muzgu n'agim

Le t'përflaket qielli tym të bëhen retë
Le të digjet hëna yjet le të shuhen
Në tejmesnatë të pres ty, ti të kthehesh vet
Kur kam dritën tënde tjerat nuk më duhen

BËHEM BRIMË

Ti vezullim që ndrin nga qielli
Vjen e zbrazesh befas mbi mua
Buzëqesh hëna skuqet dielli
Kur TI pyet pse të dua

Veç një yll dalloj n'yjësi
Që lëshon dritë e kurrë s'mbaron
Në loçkë zemre ndjej zjarrmi
Kur ti m'thua sa më don

Mos më pyet më për arsye
Pse po digjem si copë eshke
Qafës tënde qafë kumrie
I ndjej aromë lulebjeshke

Ti kur pyet si të dua
Unë hap krahët anë e kënd
Si fëmijë marr në thua
Dhe mbaroj në prehrin tënd

Mos më pyet se në ç'vend të dua
në tokë, në qiell, në fund deti
Ti je ajër, je prush je dritë
Je perlë në varg POETI

Ti betohesh në jetën tënden
Se më do sa të kesh frymë
Unë t'betohem në timen jetë
Po u mrrole unë bëhem brimë.



TÒNIA PASSOLA
(KATALONJË/SPANJË)

Tònia Passola është një poete e gjuhës katalanase e lindur në Barcelonë. Ka mbaruar studimet e larta për histori arti në Universitetin Autonoma të Barcelonës dhe është pedagoge e gjuhës katalanase dhe letërsisë në një kolegj.

Ajo është autore e këtyre botimeve: Cel rebel (2000, "Cadaqués a Rosa Leveroni prize"); La sensualitat del silenci (2001, "Vicent Andrés Estellés prize"); Bressol (2005); L´horitzó que no hi és (2009) and Margelle d´étoiles (Paris 2013, bilingual French-Catalan, (dygjyhësh frëngjisht dhe katalanas), botuar nga L´Harmattan "poètes des cinq continents").

Veprat e Tònia Passola kanë formën e një ditari personal. Duke përdorur kujtesën, imagjinatën dhe ëndrrën, ajo i kapërcen kufizimet e gjuhës dhe krijon një botë poetike të jashtëzakonshme.

Poezitë e saj janë përkthyer në frëngjisht, italisht, hollandisht, anglisht, shqip, maqedonisht, greqisht dhe spanjisht.

Ajo ka botuar studime letrare mbi disa poetë katalanas si Víctor Català, Joan Maragall, Rosa Leveroni dhe Mercè Rodoreda. Ka përkthyer gjithashtu në gjuhën katalanase një libër të poetit shqiptar Jeton Kelmendi ("Com retrobar-se "(Si të arrish veten).

Në vitin 2014, ajo u nderua me çmimin "Nënë Tereza"në qytetin e Gjakovës/ Kosovë dhe më 2015 me çmimin "Aleksandri i Madh" në ishullin grek të Salaminës.

VESHJE

Sot, ti je prapë këtu, dhe më sugjeron
Që të vesh një veshje tjetër fantastike.
Vishem sipas dëshirës tënde që është imja gjithashtu
E di, ti më josh mua dhe nuk më lë;
në koncerte, ekspozita, libra
teatër, kinema…
ne humbim të dy në parajsën e udhëtimeve të tua.
Këto veshje të tuat nuk mbarojnë kurrë,
më rrinë mënjanë me lojëra provokuese
përherë të reja, përherë në modë
si ato të librave, që të mbeten sytë në to;
si zëri i një puthje apo tradhëtie
që më kupton dhe më rrëmben me fjalë.
Tani, unë nuk i heq më,
ato shkrihen në lëkurën time,
më vezullojnë në fytyrë.
Ti je dëshira që më krijon e më rikrijon.
Sot unë dua të vij në shtëpi më herët.
Edhe vajza ime është e kallëpit tënd:
ka gëzimin e rebelimit, ashklat e mallit…
shpërthimet, mxitimin,
hallakatjen, peisazhet e gjalla
dhe në të njëjtën kohë më ndrydh mua.

Vazhdo më tundo, pastaj
më injekto një pasion të butë,
Lëri krahët e mia të hapin zjarr!
Pa dashuri s'marr dot frymë.
Pa ty do të bëhesha
një kufomë e pajetë.

MIRADA

Një vështrim i një udhëtimi
nga jashtë një qelie,
strehë e një errësire të ngrohtë,
e carë në myshk
që vaditet me vesën e frymës.

Gjethnajë besimesh,
ylber malli
qe bashkon pjalmin e lirisë.
Oh, ura e përjetimit të dikujt

mbi të cilën kalon fëmija i përgjumur,
hija e kuqe e kontureve të tij!

Kush do ta dëgjojë rrahjen e zemrës,
këngën e njëtrajtshme të ëndrës së fundit?
kush do ta dëgjojë atë kur del drita?

Stalaktite dëshire
në shpellat e lagështa të ditëve.

Heshtje e vjetër e pambrojtur.
Këngë që percepton dhe jeton cdo rrahje zemre
dhe në shkurajimin e saj nuk dorëzohet.

Vetëm murmurimë pafundësie
Vështrim i tjetrit,
Kujtimi i një udhëtimi të hershëm.

JASHTËQITJE

Si një vajzë indiane që kap me dorë jashtëqitjen
e tharë në diell
dhe e ngjesh atë në murin e lagur.
Si kenjanja Massai që i mbush duart me pleh
dhe në mes të gumëzhimës së vapës
bën llac me të për të ngritur kasollen.
Kështu mund të përdoret edhe jashtëqitja e frymës
për të krijuar nje poezi me fjalë.

Përkthyer nga Kujtim Morina

BUJAR PLLOSHTANI
(MAQEDONI)

Bujar Plloshtani, poet, eseist dhe aktivist social
Lindi më 18 dhjetor 1983, në qytetin e Tetovës.
Ka kryer studimet për Drejtësi në Universitetin e Evropës Juglindore.
Ka punuar në Organizatën SAATCHI, sektori i intervistave, në Shkup
Në Tetor 2007, themelon Shoqatën e artistëve "Pushkin" dhe zgjedhet kryetar i saj.
Në cilësinë e anëtarit të Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptarë të Maqedonisë merr pjesë në Ekspozitën e Friedrich Schiler. (Jeta dhe Vepra në kohë e shkrimtarit gjerman).
Më 2010, emërohet anëtar i Shoqatës së Poetëve të Japonisë,
Është Anëtar i Dhomës së Festivalit të poezisë "Ura Poetike AMA-HASHI", Kyoto, Japoni.
Poezitë e tij janë përkthyer në gjuhën angleze dhe japoneze, nga JUNPA Book, Japoni. Titulli i librit me poezi japoneze dhe angleze "Duet of Azure"
Është fitues i Festivalit Letrar për të Rinj "Tirana 2016" - Edicioni II Çmimi i Parë i Jurisë për Esenë "Mbi ekzistencializmin"
Ka marrë pjesë në Festivale Letrare në shkallë vendi dhe jashtë.
Është kryeredaktor në Agjencinë e lajmeve "Klosi News"
Botimet:
"Nga regjia e shpirtit" - poezi (2007);
"Traktati mbi arsyen e mendimit" - letra filozofike (2009);
"Mbi arsyen e fjalës" - poezi (2010).
"Etikë dhe Politikë" - filozofi politike (në proces)

MANASTIRET

Heshtin!
Por jo dhe kambanat!

Mure me gurë antike,
me figura të lashta mistike.

Brenda nuk hyn dielli,
ngrohen me zjarrin e qirinjve.

Betohen për mëkatet,
kryqëzohen përballë profetit të kryqëzuar.

Kube e lashtë,
e ngritur në formë vezake sipër qiellit.

Njerëzit kryejnë ritualet,
përgjërohen mureve,
dhe figurave brenda.

GURËT

Gur i rëndë.

Nuk lëviz prej vendit,
gjoja bën inat.

Pasion i rrumbullakët,
i përhimtë, egoist i pashoq.

Brendësinë me xhelozi e ruan,
e ka mbështjell si të jetë me vakum.

Gur i rëndë,
i fortë, me formë enigmatike.

Mbrëmjeve në tokë,
fytyrën zbulon,

zbardhet paksa.

Gur i rëndë,
një inatçor i rrallë mistik.

GJETH I ZVERDHUR

Vështroj një gjeth të zverdhur,
në mesin e gjithë gjetheve në degë.

Gjethi i zverdhur,
matanë dritares rri gjithë mllef.

Gjeth i heshtur, i thelluar në mërzi,
krejt indiferent përballë diellit rri.

Gjeth i zverdhur,
inteligjent, por i mynxyrshëm.

Njerëz nga mendja muf,
tallen, përbuzin, përqeshin gjethin.

Gjeth i zverdhur,
njerëz të zverdhshëm.



BELFJORE QOSE
(SHQIPËRI)

Është pedagoge në Universitetin e Tiranës, Departamenti i Letërsisë. Në të njëjtin universitet ka kryer edhe studimet e larta (diplomuar me 2007), Master i Shkencave (2011) dhe Doktoratën (2015). Është anëtare e Akademisë së të Rinjve pranë Akademisë së Shkencave. Profili i saj si studiuese dhe kritike e letërsisë është i konsoliduar nga mjaft pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare, si dhe botime shkencore brenda dhe jashtë vendit.
Si krijuese, ajo ka zgjedhur të jetë mjaft selektive në punët e saj. Ajo është në proces botimi të vëllimit të saj të parë poetik. Deri më tani ajo ka botuar disa poezi dhe tregime në revista, si: tregimet "Udhëtim", "Mbi bardhësinë" dhe "Monologu i Minotaurit" në revistën "Jeta e Re", Prishtinë (2015); ndërsa cikle poetike janë botuar në revistat"Fjala", "Jeta e re", "Poeteka", "Haemus", "Fjala Revieë" etj. Poezitë e saj janë botuar të përkthyera në rumanisht, anglisht, ndërsa tregimet në frëngjisht.
Ajo është përpjekur nëpërmjet promovimit të mjaft aktiviteteve letrare, të nxisë njohjen me autorët bashkëkohorë dhe diskutimet mbi letërsinë bashkëkohore nëpërmjet leximeve të përjavshme me shkrimtarë nëpër kafe-librari të ndryshme të Tiranës, ku kanë marrë pjesë edhe mjaft autorë të huaj. Gjithashtu, ajo ka qenë koordinatore e eventit Tirana Lexon 2015, në kuadër të Festivalit Ndërkombëtar të Letërsisë.
Së fundmi, është vlerësuar në konkursin e zhvilluar nga Ministria e Kulturës, "Fondi për mbështetjen e krijimtarisë letrare shqiptare, 2017", si një prej fituesve të këtij projekti, me përmbledhjen poetike "A jemi trupa a dritë". Një përmbledhje e poezive të saj më të mira është duke u përkthyer në anglisht dhe sipas kontratës do botohet nga Transcendence Zero Press, si një prej tre kapitujve të një antologjie me autorë shqiptarë.

AQ SA PËR TË MOS QENË E JONA

S'jam një ndër ata që mëngjeset i presin të parët,
Nata ime është e gjatë dhe përkushtimi i thellë.
Në të mësoj sesi jetën mund ta kuptosh nëse
E sheh botën si një mace nga një dritare e vjetër
Shpërfillëse dhe pasionante,
E zhdërvjellët dhe përtace.
Ata janë ndryshe nga ne,
Ne jemi ndarë prej tyre,
Tashmë dhe ajri ka kufij,
Dridhemi nga pasiguria,
A thua do na kthejnë mbrapsht nga erdhëm,
Nga toka e të dobëtëve, nga atdheu i të dobëtëve.
Dhimbjet e mija bëhen flutura,
Elan-i jot shndërrohet në myshk që vesh gurët
Aty ku Danubi rrjedh bashkë me valset
Ndërsa ne mbartim shpirtin e paraardhësve
Në këngët e tyre plot pikëllim.
Rrugët monumentale, masivet e ndërtesave,
Gjithçka kaq e rregullt sa të errëson sytë,
Ky nuk është atdheu ynë, e kuptojmë,
Kur shohim kupolat simetrike dhe arsyen e sendeve,
Kur ngjisim kodra me kopshte rrugës për në bastion,
Këtu kështjellat janë të bukura, jo tragjike
Femrat janë princesha, jo nëna me dhjetë fëmijë,
Gotikë e stërholluar dhe ekstaza e shqisave
Gjithçka kaq e bukur, sa për të mos qenë e jona.
Trupa që vrapojnë, atletikë e sterilë,
As vështrimet tona s'janë aq të shpejta,
Duam të përkapim çfarë fshihet poshtë sendeve,
Çfarë i mban gjallë këto qytete-muzeume,
Ndërkohë këpucët tona të vjetra mbushen me shi,
Flasim për aristokracinë dhe hotelin tonë të lirë
Për arkitektin gjenial dhe mahnitjen tonë prej fëmije.
Art nouveau dhe influencat e stileve,
Jemi mësuar që gjërat t'i shohim një nga një,
Kështu në këtë festë të shqisave, humbasim
përqendrimin.
Sinagoga midis katër katedraleve dhe një bazilike,
Natën, në katakombet e një prej katedraleve
mbahet meshë,
Ndërsa në sinagogën përballë luhet jazz vetëm për
besimtarët.
Dhe rrugët fillojnë të mbushen me trupa,
Birraritë shesin zhurmë dhe shkumë,
Më në fund era e urinës dhe të vjellave

Qyteti nis të marrë jetë, lëkura e tij skuqet,
Ashtu siç ditët me diell nuk do ta skuqin kurrë.
Ku janë fytyrat e vërteta, në ç'karrige prehet lodhja
A thua kjo është monotonia e rrafshët e lumturisë?
Tek ne gjithçka është shumë e thjeshtë
Njerëzit janë të bukur dhe jeta e pavlerë.
Ne jemi ndarë prej tyre, jemi dukshëm të huaj,
Ecim të pasigurt, shiu ka ndaluar,
Ajri tejngopet nga duhma njerëzore,
Nga djersa dhe afshi i gojëve.
Nuk na bën përshtypje, më tej ka rrugë të
vetmuara plot
Zgjedhim të parën prej tyre,
Kapërdijmë qetësinë e pakufishme,
Kaosin e shëndetshëm brenda rregullave të qytetit,
Jemi dy duar që kapen pas të vetmes gjë që njohin.

NGA ERRËSIRA MUND TË VIJË GJITHÇKA

Nga errësira mund të vijë gjithçka
Pika e mbrame e shiut ra
U nda në dhjetëra të tjera
Pas qafe ndjeva frymëmarrjen e një të padukshmi
Një sy i madh loton brenda tij
Ai shumëfishon vetveten
Pyll sysh dhe ujëvare lotësh
Vetmia ka mësy në shpirtin tim.

Nga errësira mund të vijë gjithçka
Një rrëqebull me fytyrë njeriu
Ulet në mes të natës,
Hap librin e fshehtë të gjetheve
Lexon psherëtimat e tyre shekullore,
Depërton terrin dhe lëkuren time dhe sheh
Një shelg të madh lotues që varet
Nga maja e malit më të lartë,
Aty ku në një tempull të kuq pandá i këndohet jetës
Sytë i shkëlqejnë nga kënaqësia,
Nuk është i vetmi që kupton
Ëndrrën e gjetheve për arrati.
Prej errësirës mund të vijë gjithçka
Qetësia është pishtar për shpirtin
I cili sheh në vend të shkëmbit të heshtjes
Një gurrë lotësh të hidhur
Janë lotët e paderdhur të burrit

Që ulërimat i mbyt në nxehtësinë e diellit,
E dridhjen e duarve e fsheh me elegancën
E atij që po aq sa unë i njeh, i ka provuar
Njëmijë shpatat e ngritura mes nesh.

Nga errësira mund të vijë gjithçka
Hëna zbret shkallë-shkallë nga qielli në tokë
Dhe më vë dorën në sup duke më derdhur në vesh
Tërë këngët e përjetshme blatuar largësive.

FUNDI DHE FILLIMI BËHEN MESNATË

Ka nga një djall pas çdo dere të shtëpisë sime
Për çdo mur që prek rrezaton gëzofi i një maceje,
Ka tela që duart m'i lidhin me hënën
Duke formuar një bisht peshku të pashkatërrueshëm,
Përndryshe rendi i universit i del duarsh krijuesit
Nga ai sistem i përsosur mekanizmash disa radhësh,
Ku... ka për çdo natë nga një vajzë të vrarë.
Na duhet të ecim në gjakun e tyre të përjetshëm
Duke zvarritur këmbët nëpër dhoma e korridore,
Ka për çdokënd nga një fytyrë që të tjerët ia shohin
E ai s'e njeh, përveç shëmbëllimeve të pasqyrave.
Ka skërmitje pas gurëve të ngritur pezull prej frymës
Ndërsa fyelli bie dhe na thërret ta ndjekim,
Ujërave të arta me varka prej himnesh ne lundrojmë,
Velat tona janë prej lutjesh dhe ujërat po stisin
vorbullat e fundit.
Nga qielli i zbrazët tingujsh na sheh
Trekëndëshi i vulvës -
Fundi dhe fillimi bëhen mesnatë.

RIZAH SHEQIRI

Rizah SHEQIRI u lind më 12 janar 1961 në Brainë. Shkollën e Mesme dhe Fakultetin i kreu në Prishtinë. Në Suedi ka studiuar për pedagogji dhe është Magjistër i Filozofisë dhe Shkencave Pedagogjike. Nga viti 1991 ka migruar në Suedi. Ka punuar kohë të gjatë si mësues dhe ka bashkëpunuar me Entin Shtetëror për Shkolla të Suedisë (Skolverket) dhe është koautor i dy librave shkollorë hartuar nga ky ent. Është bashkautorë edhe i 19 librave shkollorë për nxënësit shqiptarë në .diasporë

Rizah Sheqiri është autor i mbi dyzetë veprave letrare. Ka botuar dhe ka fituar një varg shpërblimesh për krijimtari letrare. Është përkthyer në gjuhën suedeze, gjermane, angleze, rumune etj. Krijimet e tij janë përfshirë në shumë antologji të ndryshme gjithandej botës. R.Sheqiri merret me përkthime nga suedishtja në gjuhën shqipe dhe anasjelltas. Ka prezentuar krijimtarinë e tij letrare dhe ka mbajtur ligjërata mbi letërsinë shqipe në qendra të ndryshme në Suedi, Shqipëri, Kosovë, Mal te Zi, Maqedoni, në Gjermani, Austri, etj. Publikon punime nga fusha e Pedagogjisë, ka qenë kolumnist në gazetën ditore suedeze „Sydöstran“, është lektor pranë rrjetit bibliotekar në Suedi - BTJ, dhe redaktor i revistës letrare „Groblad“. Merret edhe me fotografi artistike. Është anëtar i shumë shoqatave e forumeve kulturore ,nga fillimet e vitit 1994 anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Suedisë. Për vitin 2000 kjo Shoqatë i ndau BURSËN VJETORE PËR KRIJIMTARI. Në vitin 2002 Departamenti për Kulturë i Kuvendit të Komunës së Karlskronës i ndau Çmimin Vjetor për Kulturë. Regjioni i Blekinges i ndau Çmimin për Kulturë për vitin 2006, ndërsa Enti Shkollor i Suedisë –”Tema Modersmål dhe myndigheten för

skolutveckling“ i ndanë Çmimin”Mësuesi i vitit i gjuhës amtare 2007”. Për herë të parë ka marrë edhe Çmimin “Kosovë Rexha Bala” dhe çmimin e parë për poezi nga Festivali i Poezisë dhe i Muzikës në Malmö. Shoqata e Shkrimtarëve dhe Autorëve të Librave mësimorë në Suedi, i ka ndarë Stipendium si nga autorët e suksesshëm veprat e të cilëve gjejnë përdorim në Shkollat e Suedisë dhe të vendeve nordike. Rizah Sheqiri i ka ndarë mirënjohje Ministria e Arsimit dhe Ministria e Diasporës .e Republikës së Kosovës

POET ËSHTË VETËM ZEMRA

Sa e bukur je fjalë
I thanë fjalës

Të bukur më bën
Mjeshtër poeti

Ti je mjeshtër i fjalës poet
I thanë poetit

Ai e peshoi fjalën në zemër
:Me zemër tha

Zemra e bën fjalën e bukur
Poet është vetëm zemra

POEZI

Pasqyra më e kthjelltë e shpirtit
Ora më e mirë e ndjenjës
Eshkë dhembje - strall malli
Zemër në zemër e dashuri
.Imazh shprese në dëshirë - ëndërr e lirë

GJITHÇKA PËR TY

Dashuri
Të qoftë falë zemra
Trupi e shpirti
Dhe ndjenja ime
Dashuri

Ti meriton edhe shumë më shumë
Dashuri
Po unë s'kam tjetër çka të të falë
Përveç vargje e fjalë

PEISAZH VJESHTE

Vallëzim i shfrenuar i gjetheve të zverdhura
Nën tingujt e simfonisë së gjallë të erës
Retë gri horizontit të shkapërderdhura
Sjellin lot nga sytë e mërrolur të qiellit
Baladë për vdekjen e bukurisë së pranverës
.Mallëdhembje për rrezet e mërguara të diellit



NDUE UKAJ

(KOSOVË)

Ndue Ukaj (1977), shkrimtar, kritik i letërsisë dhe publicist.
Është i përfshirë në disa antologji të poezisë, brenda dhe jashtë vendit. Poezitë dhe tekstet e tij janë përkthyer në anglisht, spanjisht, italisht, rumanisht, finlandisht, kinezisht, suedisht, turqisht, dhe janë botuar në shumë revista. Është autor i librave: "Diskursi biblik në letërsinë shqipe", 2004 "Ujëvarat e metaforave", 2009 "Godo nuk vjen" 2010, "Ithaca of the Word" 2010, poezi, "Arka e shpëtimit," 2012, "Gjithmonë diçka mungon", 2107.
Libri me poezi Godo nuk vjen, u laureua me çmimin kombëtar "Azem Shkreli", për librin më te mirë të botuar me poezi në vitin 2010. Në Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë, "Ditët e Naimit", u laureua me çmimin për poezinë më të mirë. Revista letrare The International Poetry Transation And Research Centre, që botohet në Kinë, më 2014, e ka vlerësuar një nga poetët më të mirë të botuar në vitin 2013 në këtë revistë. Po ashtu, ka fituar çmimin Creativity prizes» në Naji Naaman's Literary Prizes 2016.
Është vlerësuar edhe me mirënjohje dhe çmime tjera letrare.
Ukaj është anëtar i PEN-it në Suedi.

ARKA E PËRMBYSJES

Shpeshherë të kam pâ mes engjëjsh e demonësh,
E rrethuar nga një aureolë e rreme e quajtur lavdi.
E kërkoje arkën e shpëtimit, një jastëk për kokën tënde
E për dëshirat tua të ngjyrosura në liri.

Fatin tënd e mbanin në dorë perënditë e detit,
Derisa një ditë aureola jote u përmbys.
Atëherë ti qave si ky qiell i pikëlluar,
E ktheve kokën prapa,
Ata sy të ambël që shikonin kah pafundësia.
Dhe matanë dhimbjes kërkove një shtrëngim dore
Trëndafilin e kuq
Sa rruzullimi i syve të tu.

Atë ditë ndjenjash të përgjumura
E kërkove kthimin te rrëfimet e vjetra
Nëpërmjet heshtjes së zymtë
Në udhëkryqe fatesh
Ujite lulet e këqija.

Çfarë të bëj unë në një natë si kjo,
Pa hanë dhe pa qëllim,
Kur lë peng udhëtimin e gjatë nëpër rrugët e egërsuara;
Ku mungon hapësira
Fjala
Mallëngjimi.
Dhe një vistër lajmesh
Për mungesën
Dikush e quan vetmi
Dikush e quan liri.

Atëherë matanë teje pashë një rrëmujë njerëzish
Si mësynin kah portat e mbyllura.
Dhe u kapa pas teje;
Pas teje aty ku thërrmijat e kujtesës bëheshin simfoni
Në ndërgjegjen e vrarë.
Një tingull që zgjatë sa një jetë.

MESDITË PRANVERE

Pas këtij dimri të acartë,
Kjo ditë ka nevojë për qartësi.

Vitet tona janë shpuar tej për tej nga kjo re pikëllimi
Që sodit mbi pranverën tonë tash e sa mote.

E sheh: unë e hodha pallton e palarë
Dhe gradualisht i afrohem diellit.

E matanë kësaj stine
Ata flasin për pamjaftueshmërinë e sendeve
Dhe një ditë që zgjat sa një jetë.

Pas këtij dimri të acarët
Pa dyshim
Kjo ditë ka nevojë për frymëmarrje dhe shumë kthjelltësi.

ITAKA SËMBON

"Unë jam e huaj në vendin tim", shkruante Edith Södergran.
S'di si do të jetë ndjerë ajo atë ditë kur frynte erë dhe binte borë.
Ajo sigurisht fliste për Itakën apo për mungesën e përhershme.
Një dhimbje që përbirohet dhe si shigjeta sëmbon.
Në të vërtetë ajo mund të fliste për mungesën e Itakës,
Për mungesën e ngjashme si atëherë kur Odiseu i afrohej limanit
Dhe s'dinte kush ishte në pallatin e ti;
Kush e shoqëronte Penelopën e ç'ndodhte me qenin e tij.

Fryn dhe bie borë.
E një grua ec ngadalë, ka frikë se do të rrëzohet.
Qartësia mungon gjithkund.
Në kohën kur sytë ngashënjehen nga portat e mbyllura.
Nga Itaka-
Dhe një grua që pret e rrethuar me imagjinatë e vetmi.

Ne gjithmonë synojmë të arrijmë te caku nëpër dallgët që rriten.

Ah! Ç'është caku?
Një shpikje e askujt apo e fuqive të mbinatyrshme-
Cakun që kurrë s'e arrijmë.

Edith shihte një pemë ma të madhe se gjitha pemët
e tjera.
Askund s'ishte gjarpri, as Eva e bukur.
E mira dhe e keqja ishin përzi si leshi në pubisin e saj.

Mjegull dhe bie borë.
Matanë kujtesës ajo ka frikë nga nata.
Muzikë s'ka askund. Është një mori zogjsh që
cicërojnë.
Refrenet joshëse për të cilat përpëlitemi si nëpër ëndrra
dimërore.

Fryn dhe bie borë. E gjethet e pemëve fëshfërijnë,
Si fustani i Penelopës kur u hodh në përqafim të
Odiseut.
Kjo është muzikë për ata që duan qartësinë,
Dhe shmangen nga mjegulla, rregulli.

Unë kthej fytyrën kah rruga e re. Aty ku s'kam kaluar
asnjëherë.
Dhe them: s'jam i huaji në vendin tim.
Pastaj e hapa përsëri librin dhe gjeta atë që Edith vërtet
shkroi:
"Unë digjem për një vend që nuk është."

RRUGËT E JETËS

Kjo mesdita e zakonshme s'ka dëshmitarë.
Mes shtigjeve të harrimit,
Dielli noton nëpër qiellin e hutuar
Dhe njësoj nxeh për të mirët e të këqijtë.

Unë rri përballë lumit të njerëzve.
Ata kërkojnë diçka:
Rrugët e jetës
Qartësinë
Kohët që s'janë
Kohët që s'vijnë...
Pastaj shoh silueta grash.
Ato kanë braktisur demonët
Me nurin e tyre që thyhet në hije malli;
Në hije që iu vijnë pas dhe formësojnë melankoli.

Atëherë të pashë në ëndërr.
Bënte vapë e ti nuk ishe askund.
As jehu i flladit tënd
As magjia e syve të tu
As tingujt e afshit tënd.

Ah! Ti më rrëfeve gjatë
Si në një tregim të bukur
Me personazhe magjikë:
"Na ishte njëherë çeta e engjëjve dhe melodia e zogjve...
Tani janë vetëm portat për dalje nga ferri."

Pastaj mallëngjimi
Ra mbi sytë e tu
Dhe i ngjau shiut;
Atij shiu që përmbyt gjithçka.

Foto: Siri Karalic Mannheimer

MAGNUS VILIAM ULSON
(SUEDI)

Magnus Viliam – Ulson (Magnus William-Olsson) i lindur më 6 nëntor 1960, është njëri nga poetët, eseistët dhe përkthyesit më aktiv dhe më të njohur bashkëkohor suedez.
Interesimet e tij për poezi e letërsi kanë filluar që heret. Në fillim të viteve 80 – ta ka ushtruar detyrën e redaktorit në revistën "80- ta". Më vonë gjatë viteve 1990 ka punuar si redaktor i Magazinës Letrare të Shtëpisë Botuese Boniers. Gjithashtu ka qenë aktiv si kritik letrar në gazetën "Aftonbladet".
Është përkthyes i poezisë klasike dhe moderne. Ka përkthyer, qoftë vetëm, qoftë në bashkëpunim me të tjerë, poetët; Sapfo, Pia Tafdrup, Konstantinos Kavafis, Antonio Gamoneda, Gloria Gervitz dhe Alejandra Pizarnik, etj.
Është njëri nga themeluesit dhe drejtuesit e Seminarit të Lirë për Kritikën Letrare që mbledh kritikët, autorët, artistët e studiuesit skandinavë në seminare, ligjerata dhe simpoziume.
Ai ka bashkëpunuar me shumë artistë dhe kompozitorë dhe ka qenë autorë e bashkautor i krijimeve të ndryshme artistike. Ai ka qenë nismëtar ose edhe i involuar edhe në shumë projekte e aktivitete kulturore e poetike, si psh. Podpoezi, është redaktor i W & W International Poetry dhe autor i një serie kritikash letrare në revistën "Ariel".
Kohëve të fundit ka themeluar, e drejton dhe redakton revistën elektronike javore të kritikës letrare për poezinë me titull" Örnen och Kråkan" (Shqiponja dhe Korbi).
Magnus Viliam – Ulson (Magnus William-Olsson) kryesisht i përkushtohet poezisë, eseistikës dhe kritikës.
Nga viti 1987 – kur ka botuar përmbledhejen e parë

me poezi ” O ‹ ” dhe deri më tash ka botuar rreth njëzetë përmbledhje nga të cilat pjesa më e madhe me poezi. Veprat e tij letrare e poetike janë përkthyer në më shumë se njëzetë gjuhë.
Ka marrë pjesë në festivale të shumta kombëtare e ndërkombëtare ku poezia dhe arti i tij poetik janë vlerësuar lartë nga lexuesit dhe n ga kritika. Magnus Viliam – Ulson (Magnus William-Olsson) është laureat i një numër të madh të Çmimeve nga më të rëndësishmet për poezi e letërsi në Suedi dhe më gjërë.
Jeton dhe krijon në kryeqytetin e Suedisë në Stockholm.

UNË VET

60 11 06
Jam lindur

Jam lindur nën yllin e kthesës
Shenja për qenësinë time
Mbyllet

Në mes të saj qëndron një pasqyrë

Simetrikisht pushoj mes shenjash
I balansuar në dhomën e zbrazët
të kthesës;

bardhë dhe o –
I paqartë

si mjegullë

EMRI

(anagram)

Dëshira ime për të jetuar, zgjohu
qe ai zëri murmuritës ditës
gati s' të mbaj mend aqë mirë
gjumash I sëmurë, unë i prekshëmi
dhe tash që ju kam lën të vdes
Motër e vogël, syri u betua
Të tashmen nuk doja ta lëndoj
Murmurimëshkruar në shkresë diellore
Eja në thirrjen tënde të vogël të vdekjes
Eja dhe bëru një me thirrjen, flej
Jam i hidhëruar në ty
Më mungon ti i lëndime
Zërin të ballafaqoj, ishte më shumë se guxim
për të zgjohuar lehtë në sy- zhurmash tash
ishte vendi im atje që s'vdes
e kam plot mall, e plagë të pashëruara
tash të ëndrroj ty, murmuritje e vdekjes
i detyruar të të fitoj ty diell
sy të papastër, më thuani të vërtetën

(PËR L)

E shkëlyeshme është sipërfaqja
kyqur
rreth heshtjes së saj

Koka pushon
në një kurorë errësire

Trupi hesht
e thellohet

Prapa ballit
Me çiltërsi fëmije
bymehet toka -

Përktheu nga suedishtja në gjuhën shqipe:
Rizah Sheqiri

(KTHIMI)

Shliruar është ëndrra

barrëlirë pushon nëna
E lumtur

në buzëqeshjen e saj të mbyllur,
budallallëku i vet
turp, i saj

- Ti ma ke borxh
  një vdekje!

BIOS DHE GRAFEIN

Jeta si të shkruarit
Të jetuarit si shkrim

Përktheu nga suedishtja në gjuhën shqipe:
Rizah Sheqiri



GUSTAVO VEGA MANSILLA
(SPANJË)

Gustavo Vega u lind në Leon me 1948, por ka jetuar në Barcelonë (Spanjë) që nga 1972. Ai diplomoi në Filozofi pran Universitetit Shën Tomas Akuinas në Romë, Filozofi dhe arte (Filozofi speciale) pran Universitetit të Barcelonës dhe të mësuarit tek Universiteti i Lion-it. Ai mori gradën e Doktorit të shkencave në Filozofinë Spanjolle tek Universiteti i Barcelonës. Teza e Doktoratës së tij është Poéticas de Creación Visual en España, 1970-1995 (Poetizmi i vizualitetit kreativ në Spanje, 1970-1995).

Vega specializoj në investigimet teorike, pedagogjike dhe aktivitete creative në tri fusha: Filozofi, Poezi dhe Artet Plastike. Tri disiplinat të cilat Vega kombinon dhe aktualisht sintetizon në punën e tij, marrjen e një esamblimi perfekt të elementeve literaro-poetike dhe arteve plastike.

Vega është njëri nga praktikuesit kryesor të artit vizual në Spanje. Arti i tij vizual visual është shumës: ideografik, kaligrafik, letrist, konkret, hapësinor, video-poetik, poezi tre dimensionale, poezi-veprimi etj. Si artist i plastikës dhe poet vizual, ai ka ekspozuar individualisht mbi 50 herë në Spanje, Argjentinë… dhe ka marrë pjesë në mbi dyqind ekspozita grupore.

Vega është autor i librave: Habitando transparencias (1982, Transparencat e banoreve), El placer de ser (1997, kënaqësinë e të qenit), Prólogo paragrafi un silenci (2001, prolog për një heshtje), La Frontera del Infinito (2005, kufiri i Infinitit), Plaza del Buen Suceso-Talleres de Creación poetica en Barcelona / Workshop Poetike në Barcelonë (1994), PoÉticas Visuales (2008, Poetika Vizuale), PINTAR la Luz / Dipingere la Luce (2012), ndër botimet e tjera.

Për vite te tëra ai ka dhënë mësim në art dhe Kulturën Historike në Universitetin e Barcelonës, BCA, si dhe poezinë vizuale në Universitetin e León-it dhe në institucione të tjera. Ai themeloi dhe drejton Ex.Tensión grup Fonética dhe de LABORATORIO Investigaciones Poético-Fonéticas (Laboratori për hetim Poetic-fonetik), i cili ka organizuar shumë recitale. Si pjesë e veprimtarisë së tij pedagogjike, ai ka dhënë seminare kreative poetike, kurse dhe seminare në Spanjë, ashtu edhe Argjentina, Bosnje dhe Hercegovinë, Francë, Angli, Itali, Uruguai, dhe Maqedoni. Rruga ku ai ishte lindur, tani quhet: "Calle Poeta Visual Gustavo Vega Mansilla".

24.05

Dëshiroja të të them...Por nuk munda.
Engjëll i shkatërruar, ende nuk mundem
Të pikturoj dritën.

Unë? Ti? Lëmsh i moskuptimit
I shkatërrimit. Ato janë sisteme komplekse
I një shprehje post poetike , Engjëjt.
Engjëjt e vdekur. Janë nyja, lidhje, të një rrjete
Ku e humbëm dëshirimin e nuk e di se çfarë,
Nuk di se çfarë.

Nga zjarrmi përvëlues i ëndrrave
Ëndërroj, plot dëshirë, krijimin e butësisë,
Midis rregullit dhe kaosit, ato të shumë-dëshiruarat
E asgjë, asnjë përcaktim Njutonian,
e mbi gjithçka, djegur
dëshirë e zjarrtë.

TË TREGOJ (TY) - DECIR (TE)-

Dëshiroja të të tregoja ty....Të ndjesh, dallgën
E brendshme, ku ndjenja përjetohet dhe shuhet
Ç'krijuan perënditë, një guaskë deti, një fishekzjarr,
Dhe një puthje të humbur në kohë,
Ose në errësirë, si një çorape e rrjepur e lypsarit
Tek kyçi i tij, diçka të përbashkët e kanë?

$x = f(y - z)$
$y = x - y - xz$
$z = xz - z$

ka një pikëtakimi misterioz midis dijes
dhe verbërisë, midis thënieve
dhe verbërisë. Dëshiruar fort
për të ardhmen dhe të tregoj,
të tregoj ty.

TË TREGOJ (TY) -DECIR(TE)-

27.05

Desha të të tregoj ty … Midis hapësirave polivalente
Ne vetëm sa këmbejmë vështrimet
Ngultas . Desha të të them ty...
Por nuk munda.

28.05

Fluturat elektrike. Si
Ti dëgjoj sytë e dikujt tjetër po të them
Të tregoj (ty)?

Jemi lindur nga ëndrra, vijmë nga ëndrra, vijmë.
Jemi ëndrra, e pavarësisht se rriten mungesat tona
Nuk dimë ti fshijmë ëndrrat, ashtu si bën mëngjesi,
Ëndrrat që ëndërruam dje,
Lindur prej nesh.

Ëndrrat, art, artifica të tregoj...

Jetën. Ëndrrat, art, artificë,
Jetë. Ato janë jetë.
Jeta.

TË TREGOJ (TY) -DECIR(TE)-

29.05

Lëkura jote? Mungesë. Si ta them...
Rrjedha ime në kohë, sëmurur nga
Vdekja, të kërkon, kërkon ty.

Por gjithmonë ka diçka që na shkatërron,
si për shembull,
Stina e ftohtë, retë, retë, gjithmonë të ndryshme nga të tjera re,
Një foto lamtumire, fytyra poliedrike e kërcënimit,

Një shenjë në ballë, ose
Një thua i ngecur në sekretet që fshehim
Nën kristalet e ca mureve
Të padukshëm ose...

Fat për ne që jeta na mbron
Nga pasionet tona.

TË TREGOJ (TY) -DECIR(TE)-

03.06

Si të ta tregoj tënden,
Ty, mua, plagën e dukshme , në mes
Të kësaj rrjedhe konstante
Oqeanesh, ose lumenjsh, të emrave
Pa emra, pa brishtësinë
E mjaftueshme, përmbledhur,

Tregu i zhurmave të mbetura
Dhe mungesave.

Fytyrat
E shitësve të zgavrave
Janë engjëj të vdekur,

Jehonë e
Asgjësë

(Turma. Turma.
Turmat))

Përktheu nga anglishtja : Entela KASI

PËRMBAJTJA

XHORXH UALLAS	9
MIGENA ARLLATI	29
ANTON BAEV	33
SILKE LIRIA BLUMBACH	37
PIERFRANCO BRUNI	41
POUL LYNGGAARD DAMGAARD	45
RIKI DASKAL	49
ELKA DIMITROVA	53
SLLAVICA GAXHOVA	57
SEMA GÜLER	61
SHAIP EMËRLLAHU	65
BARDH FRANGU	69
ARJAN KALLÇO	71
DINOS KUBATIS	75
KOPI KYÇYKU	81
NIVEDITA LAKHERA	85
GERRY VAN DER LINDEN	89
MARTA MARKOVSKA	93
NAIDA MUJKIÇ	97
XHUZEPE NAPOLITANO	101
ILJAZ OSMANI	105
MILOSAVA PAVLOVIĆ	107
EKREM AJRULI	109
TÒNIA PASSOLA	113
BUJAR PLLOSHTANI	117
BELFJORE QOSE	121
RIZAH SHEQIRI	125
NDUE UKAJ	129
MAGNUS VILIAM ULSON	135
GUSTAVO VEGA MANSILLA	139

Boton
Manifestimi Letrar Ndërkombëtar
DITËT E NAIMIT
Tetovë

Drejtor
Shaip EMËRLLAHU

Lektor
Ekrem AJRULI

www.ditetenaimit.org

Botimin e ndihmoi
LOGOS-A

CIP - Katalogjizimi në publikim
Biblioteka kombëtare dhe universitare
"Sv. Kliment Ohridski", Shkup
821-1(082.2)

VALLËZIM REFUGJATI / [përgatiti Shaip Emërllahu; përktheu Silke
Liria Blumbach; parathënia Reshat Sahitaj]. - Tetovë:
Ditët e Naimit, 2017. - 145 f. : ilustrime; 23 cm. -
(Festivali Ndërkombëtar i Poezisë "Ditët e Naimit"; Edicioni XXI)
(Biblioteka Meridiane poetike)

ISBN 978-608-4769-10-1

COBISS.MK-ID 9786084769101